



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Studime Europiane”, me profil “Politika Europiane dhe
Administrim Publik”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Marin Barleti””

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. PhD Eda Gemi
2. Dr. Elda Zotaj

Shtator/2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Marin Barleti”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Marin Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Nr. 549, date 11.11.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Nr 97 date 23.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Nr. 131, date 24.03.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE
18	Numri i studentëve:	2018-2023: 51 të regjistruar; 2018-2022: 28 të diplomuar
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Asoc. PhD Eda Gemi dhe Dr. Elda Zotaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Anilda Beqiraj, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat **27 dhe 28 Shkurt 2023** sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Studime Europiane” me profil: “Politika Europiane dhe Administrim Publik”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të profesionistëve të rinj.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Programi i studimit Master i Shkencave në “Studime Europiane” me profil: “Politika Europiane dhe Administrim Publik” që ofrohet nga Universiteti "Barleti" është pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë dhe ofrohet nga Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit.

Programi është licensuar në bazë të Urdhërit Nr.549 datë 11.11.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Në vitin 2016 i është dhënë akreditimi i parë në përmbushje të Urdhërit Nr.131 datë 24.03.2016 për plotësimin e kushteve të vendosura më herët nga Urdhëri Nr. 347 datë 17.09.2015 i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, aktualisht programi i studimit po i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm periodik në përmbushje të kushteve dhe kriterëve të legjislacionit në fuqi.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Studime Europiane” me profil: “Politika Europiane dhe Administrim Publik” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën Shqipe, 120 ECTS dhe kohë zgjatje të rregullt 2 vite akademike.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Studime Europiane” me profil: “Politika Europiane dhe Administrim Publik” i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me pedagogët e programit GVJ konstatoi se ka një kujdes të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë profesionale duke marrë pjesë në aktivitetet dhe botimet kërkimore ndërkombëtare. Studentë e këtij programi studimi vlerësuan se ata mbështën shumë nga stafi akademik dukë u përfshirë në punën kërkimore të pedagogëve.

Më datë 31.08.2023 përmes sistemit AMS dhe shkresë zyrtare Nr 13/72 Prot datë 31.08.2023 dërgohet në institucion DRVJ

Institucioni dërgon komentet e DRVJ datë 08.09.2023 me nr prot 925


IAL nuk ka komente për DRVJ , kështu që drafti kthehet në raport final



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

- I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr., datë janë:
- II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni


Nuk ka rekomandime nga akreditimi i fundit.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi L1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Studime Europiane” me profil: “Politika Europiane dhe Administrim Publik” i ofruar nga Universiteti “Marin Barleti”, ofrohet nga ky universitet në përputhje me interesat kombëtare dhe bazuar në statutin e institucionit ku si qëllim ka edukimin ndërdisiplinor të profesionistëve në fushën e politikave evropiane dhe administrimit publik. Vlen të theksohet se ky program është në linjë edhe me procesin e rëndësishëm të integritimit evropian që Shqipëria po kalon. Statuti dhe rregullorja e këtij programi e parashikojnë interesin që UniBa ka për të promovuar frymën e lirë dhe përgatitjen e individëve të angazhuar dhe profesionistë. Ky program vjen në përputhje me “Startegjinë dhe Planin e Zhvillimit Strategjik 2020-2023” [evidenca 1.3].
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Siç është parashikuar në përshkrimin e RVB për këtë sesion dhe referuar Strategjisë së institucionit, objektivat e masterit të shkencave janë në të njëjtën linjë me objektivat e vendosura nga institucioni, ku në themel është ofrimi i mësimdhënies cilësore, përmirësimi i kurrikulave (pika 14). Kjo gjë vërehet edhe në planin e zbatimit [evidenca 1.3]. Kështu, edukimi dhe zhvillimi i njohurive mbi bazën e kërkimit shkencor dhe ngritja e organizimi i studimeve të larta në cikle të studimit është në objektivat themelorë të parashikuara në statutin e institucionit (nenet 5-7). Dokumenti themelor që lidhet me organizimin e programit master i shkencave në “Studime Europiane me profil: “Politika Europiane dhe Administrim Publik”, Rregullorja e programit (neni 2-3), evidenton si objektiva kryesore të tij arritjen e 5 qëllimeve të cilat në tërësi përfaqësojnë përpjekje në linjë me strategjinë e institucionit për të kontribuar në përgatitjen e profesionistëve të aftë dhe njohës të mirë të politikave evropiane si dhe modele të funksionimit të administrative publike në vende të ndryshme të BE me qëllim përgatitjen e tyre në procesin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të BE [evidenca 1.1, 3].
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për	Ky program është hartuar në përputhje me strategjinë e institucionit dhe në zbatim të akteve që rregullojnë institucionit. Ky është një program i cili është hartuar për studentë dhe profesionistë të dëshirojnë të ndjekin




zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	studimet master dhe të thellojnë dijet ku si synim kryesor kanë punësimin në administratën publike. Njësia kryesore që ofron këtë program është Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë dhe njësia bazë Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit.		
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është në harmoni të plotë me interesat kombëtare të vendit dhe procesin e integritimit në BE. Vlen të theksohet që është një program masteri ndërdisiplinor i cili katalizon te studentët që ndjekin këtë program një ndërthurje të teorisë dhe praktikës e politikave të BE dhe vendeve anëtare dhe procesit të integritimit. Këto janë elementë të rëndësishëm sepse u mundësojnë studentëve përvetësimin e dijeve mbi zhvillimet e fundit në BE. Në vitin 2020, ky program ka pasur një riorganizim në masën 20% duhe shtuar disa lëndë të nevojshme për programin [evidenca 2.1]. Kurrikula e programit master i mundëson studentëve të analizojnë praktikën e mira doktrinare si teorike, si praktike, duke reflektuar mbi zhvillimet e më të fundit në tërësinë e aspekteve teknike që lidhen me zhvillimet aktuale në BE dhe Shqipëri [evidenca 1.1, 1.3, 2.1].		
Konkluzione	<i>Bazuar në sa më sipër vlen të theksohet se standarti I.1 i kriterit I është i përmbushur plotësisht dhe institucioni e ofron programin e studimit në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi, strategjinë e institucionit dhe rregulloret.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Struktura akademike e masterit të shkencave është zhvilluar përmes një bashkëpunimi mes pedagogëve me përgatitje të shkencave politike, ekonomike, juridike, dhe shkencave sociale nga degë të ndryshme, si dhe bashkëpunim mes lektorëve me orar të plotë dhe pedagogëve me kohë të pjesshme. Për më tepër, kurse specifike — si për shembull lënda “Integrimi Ekonomik Ndërkombëtar” - që ka nevojë për praktikë ekonomike ligjërohet nga pedagogia me kohë të pjesshme e cila vjen nga sektori bankar dhe konkretisht nga Banka e Shqipërisë. Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit vihet re se përmbush kriteret ligjorë të angazhimit të 7 pjesëtarëve personeli akademik me kohë të plotë ku 3 nga këta anëtarë mbajnë gradën shkencore ‘Doktor’ dhe 4 janë asistent lektorë dhe 3 anëtarë personeli akademik me kontratë (PAK). Nga stafi akademik me kohë të plotë pranë këtij departamenti, vetëm

	<p>Përgjegjësi i Departamentit, Dr. Shpëtim Cami është i angazhuar në mësimdhënie në programin në fjalë dhe është titullar dhe pedagog i 4 lëndëve të programit master. <i>Vërehet se përgjegjësi i departamentit ka një mbingarkesë të orëve në auditor së bashku me Profesor Ismail Tafanin. Vlen të theksohet së për efekt të diversifikimit të përcjelljes së qasjes akademike, lind nevoja e angazhimit të më shumë lektorëve ose bashke-lektorëve të cilët mbajnë gradën shkencore 'Doktor' në këto lëndë.</i> Sipas evidencave personeli akademik është i kualifikuar në fushat ku ata zhillojnë aktivitetin e mësimdhënies dhe atë kërkimor [evidenca 30 & 38, tabela 2, 6].</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MSH “Studime Europiane” me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” në tërësinë e tij, është në kohezion të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Kodifikimin kombëtar i tij është bazuar në nenin 86 dhe nenin 125 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, i cili është një prej tre departamenteve bazë të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (njësia kryesore). Ky Fakultet përbëhet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit dhe Departamenti i Drejtësisë [evidencat 1, 1.2].</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Master i Shkencave në “Studime Europiane” me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” ofrohet bazuar në Ligjin Shqiptar dhe në përputhje me Strategjinë e UniBa 2020-2023. Programi ofrohet nga Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit. Në këtë program angazhohen shtatë personel akademik me kohë të plotë, 3 prej të cilëve janë me titull akademik ose grade shkencore dhe të tjerët janë me MSc. Staf i akademik i angazhuar në këtë program është nga departamente të tjera nisur nga qasja ndërdisiplinore që ka ky program. Bazuar në udhëzimet kombëtare dhe evropiane, programi i ofruar nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit zhvillohet me kohë të plotë, në një kohortë 24 mujore. Është i shtrirë në katër semestere ku dy komponentët e fundit i dedikohen studentit që shkruan një tezë nën supervizionin e profesorit dhe zhvillon praktikën profesionale. Programi zhvillon një kuptim sistematik të thelluar të studimeve evropiane dhe politikave të BE dhe administrimit publik dhe siguron aftësitë e nevojshme për të analizuar dhe vlerësuar problemet komplekse ligjore dhe çështjet e ndërlidhura [evidenca 1.3, 2, 30].</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>NA</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe planin e zbatimit, vlen të theksohet se UniBa ka krijuar struktura të brendshme të cilat ofrojnë trajnime të ndryshme për studentët, të diplomuarit dhe profesionistët e interesuar, siç janë Barleti Training and Testing Center. <i>Por, bazuar në vizitën e bërë në institucion dhe evidencat e sjella nga raportimi i institucionit si evidenca e përgjegjës të zyrës Alumni [evidenca 20.1.3], institucioni ka nevojë të krijojë një sistem 'follow-up' në bashkërendimin e aktiviteteve dhe trajnimeve.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në analizën e standartit I.2 programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. <i>Por, vlen të theksohet që në analizën e këtij kriteri vërehet se ka nevojë për rritje të numrit të stafit akademik duke diversifikuar ofertën akademike të këtij programi dhe ulje të ngarkesës akademike të përgjegjës të departamentit që ofron këtë program.</i></p> <p><i>Vërehet që në raportin e vlerësimit të brendshëm ka një konfondim të termit 'Evropian' dhe 'Europian' në analizën e bërë nga grupi i punës për këtë program. Sugjerohet të reflektohet ndryshimi i termit/emrit edhe në dokumentat e tjera dhe të jetë në përputhje me urdhërin e hapjes së programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.3 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Realizimi i programit sigurohet nga një staf burimesh njerëzore të kualifikuar si në drejtimin akademik edhe në atë administrativ apo institucional. Në rregulloren e Fakultetit dhe në rregulloret e njësive bazë/departamenteve janë përcaktuar qartë detyrat dhe detyrimet e secilit funksion (evidencat 1, 38). Departamenti merr masat që:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) personeli akademik me kohë të plotë (PAE) dhe ai me kontrate (PAK) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor akademik, (b) personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim të vazhdueshëm duke krijuar kushte optimale me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. <p>IT-ja siguron mbulimin e shërbimeve online dhe ka patur rol të rëndësishëm për realizimin e procesit mësimor në kohë dhe sipas kërkesave të stafit akademik dhe të studentëve, veçanërisht nëpërmjet platformës online si google classroom [anekset 1 – 5.1].</p>



	<p>Gjithashtu, biblioteka është në funksion të realizimit të këtij programi studimi [aneksi 8, evidenca 25 – 25.1]. Vërehet se në bibliotekën fizike librat datojnë në data botimi mbi 5 vite. UniBa ka siguruar biblioteken online me anë të platformave të ndryshme [evidencën 25].</p> <p>Sekretaria, arkiva, shërbimi i informacionit në zyrat e ndryshme janë në shërbim me kohë të plotë në mënyrë operative, funksionale në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Cdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit respektivë.</p> <p><i>Ka nevojë për përmirësim të faqes online në mënyrë që institucioni të përmirësojë shërbimet online jo vetëm duke dhënë informacion por duke përmbushur objektivat e vëna nga strategjia e zhvillimit për të pasur digjitalizim të institucionit</i> https://students.umb.edu.al/sherbimet-studentore.html.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UniBa në funksion të realizimit të programit të studimit, që ka një profil të theksuar ndërdisiplonor, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit. Këto marrëveshje janë lidhur për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për zhvillimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar dhe aktorët e biznesit. Në këtë drejtim strategjia e ndërkombëtarizimit (evidenca 13) ka si objektiv të saj krijimin e partneriteteve ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje për praktikën e studentëve me institucione të ndryshme dhe në planin mësimor parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale përpara punimit të diplomës. Lista e institucioneve që UniBa bashkëpunon ka si fokus afrimin e studentit me tregun e punës [evidenca 10.1, 14, 15].</p> <p><i>Sa i përket kërkimit shkencor si edhe mobilitetit të personelit akademik vlen për tu theksuar se nga raportimi i shkëmbimeve me anë të programit 'Erasmus' nuk ka të dhëna të shkëmbimit të stafit të angazhuar në këtë program në një nga universitetet partnere. Vetëm një studente ka kryer shkëmbim gjatë vitit akademik 2022-2023.</i></p> <p><i>Sugjerohet rritje e mobiliteteve për këtë program studimi dhe rritje e ofrimit të bursave në këtë program studimi duke nisur nga numri i pakët i studentëve. Vëmendje e veçantë duhet të kushtohet këtij programi studimi në përputhje me strategjinë e institucionit dhe atë të ndërkombëtarizimit. Edhe pse vihet re se institucioni ka bërë përpjekje për krijimin e kushteve për kërkimin shkencor, nevojitet krijimi i një fondi të dedikuar për mbështetjet kërkimin shkencor të personelit akademik dhe angazhimt aktiv të studentëve me evidenca të qarta.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Sipas evidencave të disponueshme çdo vit Përgjegjësi i Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit përpilon raportin e analizës vjetore [evidenca 22.1]. Në këtë raport përmbledhen marrëveshjet në funksion të rritjes së performancës së institucionit në përgjithësi. <i>Por lind nevoja e rritjes së marrëveshjeve me institucione ose organizma ku</i></p>

	<i>në thelb kanë përmbajtjen e këtij programi. Vërehet mungesë e raporteve analitike mbi marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe të huaja dhe vendase atje ku ka pasur përfitime.</i>		
Konkluzione	<p><i>Bazuar në analizën e standartit I.3 vërehet se Universiteti "Marin Barleti" dhe njësitë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e programit sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtare dhe kombëtarë për realizimin sa më efektiv të këtij programi.</i></p> <p><i>Megjithatë, duhet të lihet në vëmendje të institucionit se duhen më shumë përpjekje për të siguruar bashkëpunime efektive të natyrës së shkëmbimeve të stafit dhe studentëve ku fokus të jetë programi në fjalë. Gjithashtu, lind nevoja e krijimit të një fondi të dedikuar për kërkimin shkencor dhe mbështetjen e stafit akademik të angazhuar për këtë program studimi si dhe drejtimin e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe projekteve.</i></p> <p><i>Megjithëse institucioni i arsimit të lartë ka autonomi akademike në angazhimin e stafit akademik përsa i përket ngarkesave, por vihet re që një pjesë e stafit në këtë program është i mbingarkuar.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të	Programi Master Shkencor në "Studime Evropiane" me profil "Politika Evropiane dhe Administrim Publik" është i organizuar sipas sistemit Evropian të Transferimit të Kreditit (ECTS), në total 120 ECTS. Programi ofrohet në kurse të ndara në dy vite akademike bazuar në plotësimin e nevojave të studentëve që ndjekin këtë program dhe natyrës së lëndëve të ofruara. Për shembull, lëndët me natyrë formuese teorike

<p>Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>dhe lëndët si ‘Metoda Cilësore të Kërkimit’, ‘Metoda Sasiore të Kërkimit’ dhe ‘Hartim dhe Menaxhim Projektsh’ ofrohen vitin e parë [evidenca 2].</p> <p>Numri i krediteve (ECTS) në programin e riorganizuar është përcaktuar duke u bazuar në rëndësinë dhe natyrën e tyre në çdo semestër. Një vit akademik përmban 60 ECTS të cilat studentët kanë të drejtë t’i ndjekin. Kategorizimi i lëndëve, duke filluar nga lëndët bazë në ato të specializimit, bëhet duke marrë parasysh njohuritë që pritet të nxënë studentët. 1 ECTS përmban 25 orë gjithsej në auditor (leksione & seminare) dhe punë individuale në formën e projekteve, detyrave të kursit, etj., sipas VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar) dhe Rregullores së Programit [evidenca 2, 3, 30]. Ky program është riorganizuar në masën 20% në vitin 2020 duke ju përshtatur nevojave të tregut [evidenca 2.1, 1.4].</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit synon, nëpërmjet secilës lëndë, t’u japë studentëve terminologjinë e duhur për formimin e tyre profesional që kombinon teorinë dhe praktikën e politikave evropiane dhe modelet më të mira të administrimit publik.</p> <p>Në syllabusin e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxënit dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde.</p> <p>Aftësitë shprehimore teknike i lejojnë studentët për t’u përballur me specializime profesionale në punë të kualifikuara ku nevojiten njohuritë që lidhen me politikat evropiane dhe administrimin publik.</p> <p>Studentët pasi të kenë mbaruar këtë cikël studimi të jenë të aftë të marrin kompetencat dhe të kontribuojnë në profesionin e tyre duke pasur njohuri të thella të qasjeve analitike në fushën e politikave dhe politikbërjes së BE-së.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi në vlerësim është i strukturuar në kurrikulën e lëndëve bazë (12 ECTS), lëndë të detyrueshme (31 ECTS), lëndë ndërdisiplinore (17 ECTS), lëndë plotësuese (12 ECTS) ku përfshihet praktika profesionale dhe detyrime përmblylëse (18 ECTS) ku përfshihet tema e diplomës. Për t’u diplomuar në këtë program, studentët duhet të fitojnë një minimum prej 120 ECTS [evidenca 3].</p> <p>Elementët përbërës të strukturës së programit të studimit janë në përputhshmëri me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor të RSH-së nr. 80/2015, dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Ai zbaton kërkesat e akteve rregullatore të institucionit, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe specifike për programin. Çdo modul ka të specifikuar qartë kreditet në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë. Në tërësinë e vlerësimit konstatohet fakti që hapat pozitiv dhe reflektimet mbi programin janë pasqyruar tek programi i riorganizuar në 2020 [evidenca 2.1 & 2.3].</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë</p>	<p>NA</p>

<p>mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat mbi pranimin, transferimin dhe përzgjedhjen e studentëve janë parashikuar në aktet e brendshme të institucionit mbi bazën e kriterëve të përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015.</p> <p>Procedura të hollësishme janë parashikuar në dokumentin “Politika e Pranimi të Studentëve, Procedura e Regjistrimit të Studenteve, Databaza e Studentëve/ Regjstri [Evidenca 18-19].</p> <p>Kriteret e regjistrimit janë publikuar dhe në faqen zyrtare elektronike të institucionit (https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/mse-politika-evropiane-dhe-administrim-publik.html) e cila është e aksesueshme nga cilido i interesuar.</p> <p>Informacione të hollësishme studentëve iu sigurohen si përmes faqes së internetit ashtu edhe nga zyra e pranimi dhe regjistrimit. Informacioni është lehtësisht i kuptueshëm dhe përfshin të dhënat e nevojshme.</p> <p>Pranimi i studentëve që ndjekin programin master është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë statuti i UniBa, Rregullat dhe udhëzimet dhe Rregullorja e programit [Evidencat 1, 1.1, 2, 3, 18-19, 33].</p> <p>Neni 6.2 i Manualit për rekrutimin e studentëve të programit përcakton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim dhe procedurën që duhet ndjekur. Procedurat e detajuara gjenden në dokumentin e regjistrimeve dhe transferimeve [evidenca 18-19& 33]. Pranimet e studentëve bëhen në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore dhe kriteret e pranimi të vendosura nga njësitë bazë e njësitë kryesore [evidenca 18.2].</p>

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	NA								
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit MSH “Studime Europiane” me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” në tërësinë e tij është në kohezion të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Kodifikimin kombëtar i tij është bazuar në nenin 86 dhe nenin 125, të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, i cili është një prej tre departamenteve bazë të Fakultetit [Evidencat 1.4, 2, 30 tabela 9].								
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA								
Konkluzione	<i>Vlen të thekohet se shkalla e përmbushjes së standartit II.1 është e përmbushur plotësisht. Do të sugjerohej që institucioni në vitet në vijim të shtojë numrin e lëndëve me zgjedhje në program.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standartit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Në bazë të nenit 7 të Statutit, UniBa ka për qëllim të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme në përputhje me kuadrin ligjor e institucional të Republikës së Shqipërisë dhe Kornziën Evropiane të Kualifikimeve EQF dhe KSHK. Për të përmbushur këtë mision dhe qëllim Institucioni ka në përbërje të tij tre fakultete nga të cilët, Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë përbëhet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, Departamenti i Drejtësisë dhe Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikim. Sipas të dhënave nga viti akademik 2019-2020 deri në vitin akademik 2022-2023, Departamenti ka patur dhe vazhdon të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë, nga të cilët të paktën 3 kanë qenë me gradën shkencore “Doktor” [evidenca 1.1, fq. 33, evidenca 1.4, 30].

	<p>Drejtuesi i njësisë kryesore mban titullin 'Prof. Asoc.' siç vërehet në faqen e internetit të institucionit (https://feqd.umb.edu.al/upload/docs/Short-bio-departamenti-Mateo-Spaho.pdf).</p> <p>Veprimtaria e fakultetit dhe departamentit mbështetet në aktet rregullatore të UniBa dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat përkatës.</p>		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Angazhimi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është përgjithësisht i përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit të studimit. <i>Sidoqoftë programi ka një problematikë të ndjeshme në drejtim të numrit të ulët të stafit efektiv me gradën shkencore 'Doktor' ose titullin 'Profesor', si dhe stafin e angazhuar në programe të studimeve doktorale. Kjo situatë është sidomos e ndjeshme në rastin e personelit të brendshëm i cili përveç ngarkesës akademike në programin në fjalë, ka ngarkesë mësimore në programet që ofrojnë departamentet ku ky staf është i atashuar [evidenca 30, tabela 4].</i></p> <p>Në suksesin e këtij programi rol të rëndësishëm luajnë njësitet mbështetëse përfshirë edhe stafin administrativ. Rol të rëndësishëm luan Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë [evidenca 35], e cila merret me ruajtjen e standarteve të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Çdo student pajiset me paketën e praktikës mësimore ku mbikqyret nga një pedagog ose koordinatori i departamentit [evidenca 2.3].</p>		
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Koordinatori i programit është i parashikuar në aktet rregulluese të UniBa. Duke pasur parasysh numrin e vogël të studentëve në këtë program studimi, institucioni krahas përgjegjësit të departamentit ka caktuar një koordinatör të programit, pozicioni i cili që nga viti 2022 (14/10/2022) mbahet nga Znj. Fatjona Qurku e cila është anëtare me kohë plotë në pozicionin e asistent lektore pranë këtij departamenti [evidenca 3.1 & evidenca 30, tabela 2].</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Për sa më sipër, konkludohet se njësitet përgjegjëse për këtë program studimi përmbushin kërkesat dhe standartet e cilësisë për ofrimin e programit të studimit. Do të sugjerohej që institucioni të rrisë numrin e stafit akademik me kohë të plotë për këtë program studimi dhe të ofrojë mekanizma mbështetës për zhvillimin akademiko-shkencor të stafit ekzistues të kategorisë asistent lektor.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, si njësi kryesore, ofron informacionin e nevojshëm për studentët dhe stafin akademik. Informacioni lidhet me programet mësimore dhe elementët e tyre. Çdo program studimor i ofruar nga njësi bazë që lidhet me programin e studimit Master Shkencor në “Studime Evropiane” me profil “Politika Evropiane dhe Administrim Publik” përmban emërtimin e lëndëve, kreditet përkatëse, numrin e orëve mësimore në auditor dhe ato të punës individuale të studentëve, titullarët e lëndëve dhe elementë të tjerë të programit të çdo lënde [evidenca 2, 2.1, evidence 30, tabela 4].</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Studime Evropiane” me profil “Politika Evropiane dhe Administrim Publik” është i organizuar në 2 vite akademike (4 semestra). Këto informacione janë të detajuara edhe në programin e lëndës, pra se në cilin vit akademik dhe semester ofrohet lënda e këtij programi studimi.</p> <p>Çdo vit akademik përmban 60 ECTS me ndarje të lëndëve të tipologjisë A, B, C, D dhe E. Gjuha e programit të studimit është Shqip [shih evidencën 2].</p> <p>Në evidencën shihet që programet e lëndëve, rregullorja e programit dhe programi mësimor disponohen edhe në anglisht sipas kriterëve të kërkuara. Këto evidencë janë pa numër por respektivisht të emërtuar.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon një infrastrukturë të mirë sistemi informacioni në lidhje me informimin e studentëve përsa i përket kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto kriterë gjenden edhe në faqen e internetit të institucionit. Kanalizimi i këtij informacion kryhet në rrugë të ndryshme. Në rregulloren e fakultetit nëni 15, etj., shprehen qartë këto informacione [evidenca 1, 19.1, 18-19]. Sipas evidencave të vëna në dispozicion për vitin akademik 2022-2023 kuota për këtë program masteri ishin 33 [evidenca 18.2]. <i>Sugjerohet që institucioni të ndërmarrë politika proaktive për të rritur numrin e studentëve në këtë programi studimin në vitet në vazhdim.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Numri i vogël i studentëve bën të mundur që stafi akademik t’i sigurojë studentëve gjithë informacionin e nevojshëm sipas lëndëve. Gjatë fillimit të lëndës studentëve u vihen në dukje elementët kryesorë procedural që duhen respektuar për të avancuar në proceset akademike. Këtu përmbledhen si ngarkesa e punës, orët në auditor, frekuentimi/ndjekja e programit dhe specifikat e secilës lëndë, duke i kushtuar vëmendje përbërësve të plan-programit të tilla si praktikën, ushtrimet ose orët laboratorike [evidenca 2].</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale</p>	<p>Ky program studimi ka qënë në procese vlerësuese të vazhdueshme, duke pasur parasysh akreditimin me kusht që ky program studimi ka pasur në vitin 2015 ku me vendimin nr. 142, date 18.02.206 Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë rekomandoi që ky program studimi të akreditohet [evidenca bashkëngjitur me emërtimet përkatëse]. Në vitin 2020, ky</p>

dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	program i është nënshtruar procesit të riorganizimit nën 20% [evidenca 2.1] me qëllim përmirësimin e programit.		
Konkluzione	<i>Për sa më sipër vlerësohet se programi është i organizuar në përputhje me të gjitha standartet e parashikuara të programeve të ciklit të dytë të studimeve, objektivat dhe misionin e Universitetit "Marin Barleti".</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Programi i studimit MSH në "Studime Evropiane" me profil "Politika Evropiane dhe Administrim Publik" është i organizuar në bazë të sistemit evropian të transmetimit të krediteve (ECTS). Organizimi strukturohet në kurrikulën e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore ose integruese (ku vërehet se janë 3 lëndë) të përcaktuara paraprakisht (Hartim dhe Menaxhim Projektësh, Metoda Cilësore të Kërkimit, Metoda Sasiore të Kërkimit), lëndë plotësuese, dhe detyrime përmbyllëse siç parashikohet në kuardin ligjor. <i>Do të sugjerohej që të shtohen lëndët me zgjedhje si ofertë akademike për studentët.</i></p> <p>Për t'u diplomuar nga ky program Master i Shkencave, një student duhet të fitojnë së minimalisht 120 ECTS në të gjitha komponentët në përputhje me shpërndarjen e tyre. Sipas riorganizimit nën 20%, struktura ka kaluar nëpër disa ndryshime që lidhen kryesisht me zhillimet aktuale dhe ndryshimet strukturore dhe staturore që ka pasur universiteti dhe strategjinë e zhvillimit të programeve që ofron Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit [evidencat 2.1, 5, 30 tabela 10].</p>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	<p>Në programin e studimit MSH në "Studime Evropiane" me profil "Politika Evropiane dhe Administrim Publik", lëndët themelore dhe metodat kërkimore janë të kombinuara me kurse të specializuara të avancuara të fushës së politikbërjes në BE dhe aspekteve të saj siç janë integrimi ekonomik, politika e brendshme dhe e jashtme e BE. Departamenti ka kryer një studim tregu të punës për programin në proces akreditimi i cili nxjerr në pag nevojat e pa përmbushura të tregut të punës dhe vendet e mundshme të punësimit [evidenca 4]. Kështu, analiza e tregut shoqërohet edhe me vëzhgimet periodike të evolucionit të kërkesë/ofertës janë bazuar në nevojat që kanë sektori publik dhe privat për burime njerëzore në fushën ekspertëve të studimeve dhe projekteve evropiane. Referuar lëndëve mësimore, programi i studimit arrin të</p>

	përbush objektivat formues të programit studimor me rezultatet të kënaqëshme të të nxënit.						
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Departamenti përgjegjës i këtij programi kryen një analizë vjetore për të parë nëse janë arritur objektivat e programit si dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional për studentët [evidenca 22.1]. Programi i studimit “Studime Evropiane” me profil “Politika Evropiane dhe Administrim Publik” është i mirë-strukturuar ku lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në simetri të plotë me atë çka kërkon një program i një niveli “master”, jo vetëm në nivel kombëtar por edhe më gjerë në atë rajonal për studentët shqiptarë të diasporës. Në dosjen e plotë të programit syllabuset dhe planet mësimore përcaktojnë qartë dhe në mënyrë eksplicite emërtimi, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë të lëndës apo modulit.						
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Syllabuset e lëndëve në programin e studimit parashikon se kontrolli i dijeve është i ndarë në: pjesëmarrjen aktive në auditor, detyra përgjatë semestrit, provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar. Krahas “Detyrimeve Përmbyllëse” që përkon me disertacionit përfundimtar, departamenti organizon dhe koordinon edhe praktikën e punës për studentët që ndjekin këtë program dhe organizon rregullisht seminare, leksione të hapura dhe mbledhje të hapura me departamentin në formën e konsultimeve [evidencat 2 & 32].						
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Stafi akademik përgjegjës për zhvillimin e lëndëve në këtë program studimi përditëson periodikisht programet e lëndëve, duke mundësuar për studentët literaturën dhe njohuritë për përfitim të dijeve. <i>Në secilin syllabus pasqyrohet qartë literatura por vlen të theksohet se literatura e detyrueshme është e pa përditësuar dhe me botimet e fundit qoftë elektronike apo hardcopy [evidenca 2].</i>						
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Në syllabuset e lëndëve tek pjesa përmbledhëse dhe rezultatet e të nxënit, përshkruhet objektivi, synimet dhe kompetencat që studentët përfitojnë në fund të lëndës. Po ashtu, në rregulloren e këtij programi është e përcaktuar qartë që përmbajtja e lëndëve dhe moduleve duhet të garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për studentët [evidenca 2].						
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Në kuadrin e përmbajtjes së përgjithshme të programit të studimit në fjalë, GVJ konstaton se vijueshmëria është e mundshme në profesionet që lidhen me studimet evropiane të sidomos për tregun e administratës publike apo organizatave që merren me projekte zhvillimore evropiane. Studimi i tregut të punës tregon vëmendje nga ana e Institucionit kundrejt nevojave të tregut të punës (evidenca 2 & 4).						
Konkluzione	<i>Ky standard i përmbush të kriteret e akreditimit. Sugjerohet përditësim i literaturës në programet e lëndëve.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.5			
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	UniBa në funksion të përmirësimit të programit të studimit ndërmerr një sërë aktiviteteve siç shihet nga evidencat e kalendarit të departamentit mbajtja e takimeve të hapura në departament [evidenca 32]. <i>Përsa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare dhe konsultimit vërehet që institucioni disponon një listë të gjatë të institucioneve partnere por nuk ka një dokument ku të tregojë aktivitetet konkrete të përmirësimit të programit të studimit në bashkëpunim me aktorët e tjerë [evidenca 15].</i> Vlen të theksohet se në vitin 2020, universiteti ka riorganizuar programin nisur nga ndryshimet që UniBa duke u bërë një institucion jo vetëm aplikativ por edhe kërkimor [evidenca 2.1].		
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Vehet re se institucioni, me anë të zyrës së Alumni dhe Karrierës, ka zhvilluar një sërë aktiviteteve në rang institucional [evidenca 20.1.1] Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, zyra e Karrierës dhe Alumni ka organizuar një pyetësor për të gjithë të diplomuarit. <i>Por, vërehet një numër i vogël i studentëve që e kanë plotësuar këtë pyetësor, vetëm 87 alumni [evidenca 20.1.3].</i> Pavarësisht nga si më sipër, duhet theksuar se institucioni ka bërë përpjekje për të mbajtur kontakte me studentët e diplomuar.		
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Bashkëpunimi dhe Partneriteti me universitete të tjera, si dhe organizata qeveritare e joqeveritare, kanë qenë në qendër të vëmendjes së UniBa këto vitet e fundit, në veçanëri nga momenti i ndryshimit të statusit nga SHLUJ në Universitet. Qëllimi i UniBa gjatë gjithë viteve ka qenë mbajtja dhe përmirësimi i një rrjeti të partneriteteve dhe marrëdhënieve kombëtare dhe ndërkombëtare [evidenca 15]. <i>Është e nevojshme të lidhen më shumë marrëveshje me fokus programin e studimit në fjalë si me institucione shqiptare edhe me ato të huaja, siç mund të jenë organizata apo qendra kërkimore.</i>		
Konkluzione	<i>Lidhur me këtë standard duhet theksuar se institucioni tregon një rol proaktiv në rritjen e numrit të partneriteteve dhe përmirësimit të programit të studimit. Por, vlen të theksohet që institucioni duhet të marrë masa të mbështesë këtë program studimi duke ndërtuar në strategji për rritjen e numrit të studentëve, përthithjen e fondeve të huaja në formën e projekteve të BE-së - siç mund të jetë Jean Monnet apo projekte të tjera rajonale - në mënyrë që ky program të fuqizohet dhe të krijohet një rrjet i fuqishëm të diplomuarish.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.6				
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në strategjinë e zhvillimit institucional të UniBa, përcaktohen prioritetet e zhvillimit dhe objektivat kryesorë të studimit [evidenca 3]. Vlen të theksohet se institucioni ka vënë në dispozicion strategji të zhvillimit të programeve që ofron Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit [evidenca 5]. Njësia bazë (departamenti) ushtron kompetenca në bazë të parashikimeve ligjore. Organizon dhe bashkërendon punën institucionale dhe akademike. Realizimi i këtij synimi kërkon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit, formimit teoriko-profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera me interes të ndërsjelltë [evidencat 1, 1.2, 5].			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Bazuar në evidencën që përcakton lirinë akademike dhe financiare të institucionit [evidenca 6], njësitë kryesore ushtrojnë aktivitetin e tyre akademik bazuar në rregullat dhe politikat e tyre, siç janë rregullorja e njësisë kryesore dhe asaj bazë [evidenca 1].			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<i>Bazuar në evidencat dhe takimin me aktorët institucional të UniBa vërehet një mungesë e pjesëmarrjes aktive të studentëve për angazhim në projekte apo në aktivitetet kërkimore, edhe pse, si pjesë të komponentit të programeve të lëndës, studentëve ju kërkohet të përgatisin detyra kursi [evidenca 2]. Ky fenomen vihet në dukje edhe për shkak të numrit të ulët të studentëve.</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<i>Siç vërehet nga RVB dhe takimi i bërë në institucion, për këtë program studimi ose në nivel departamenti, institucioni ka nevojë të rrisë mbështetjen financiare si për stafin akademik por edhe për studentët dhe të dedikojë një fond për kërkimin shkencor siç edhe parashikohet në strategjinë e institucionit.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka bërë përpjekje serioze për realizimin sa më efektiv të programit të studimit por lind nevoja e krijimit të një fondi të dedikuar për departamentin përgjegjës për këtë program studimi në mënyrë që të rritet kërkimi shkencor dhe të arrihen objektivat e vendosura në strategjinë e zhvillimit institucional. Gjithashtu nevojitet një plan pune e shoqëruar dhe me mbështetje financiare, i cili do të mundësonte mbështetjen për të rritur dhe përthithur sa më shumë studnetë në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).				
Konkluzione	Për sa më sipër theksohet se ky standart është i përmushur bazuar në kriteret dhe kushtet për akreditim të programit.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Na për	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Na për	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët janë përgjithësisht adekuate/bashkëkohore dhe kjo flet për përpjekje serioze nga ana e stafit të UniBa në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Gjatë procesit mësimor, stafi akademik përdor mjete bashkëkohore të mësimdhënies, siç janë mjetet audio-vizive. Çdo sallë auditori është e pajisur e video-projektor çfarë mundëson një komunikim më interaktiv [evidencat 2, 11, aneksi 1, 3]. Kjo gjë vërehet edhe nga politika për të mësuarit, mësimdhënien, dhe cilësinë në mësimdhënie [evidenca 11].
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Stafi akademik i angazhuar në programin studimit Master Shkencor në “Studime Europiane” me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik”, përmes metodave të mësimdhënies, të cilat janë të lidhura dhe me qëllimin dhe objektivat e lëndëve përkatëse, përdor metoda të ndryshme si ato analitike të transmetimit dhe kontrollit të dijeve. Institucioni është përgjegjës dhe i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij nga çdo sugjerim që vjen qoftë nga studentët qoftë edhe nga subjektet e tjera publike dhe private. UniBa siguron mundësi të barabarta pranimit tek studentët duke pasur parasysh edhe kampusin e ri ku UniBa ushtron aktivitetin akademik [evidenca 11].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit.	UNIBa ka një politikë mbështetëse ndaj personelit të tij akademik në mënyrë që rrisin aftësitë e tyre profesionale dhe pedagogjike. <i>Por, marrëveshjet e bashkëpunimit kanë nevojë të rriten në numër, gjykuar kjo dhe nga fakti që shkëmbimet e personelit të angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara [evidencat 10, 10.1, 14].</i>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik është kompetent në lidhje me programet e studimit dhe përgjithësisht në përputhje me fushën kërkimore të lektorit me lëndën specifike që ai mbulon. Përdoren metoda alternativa të mësimdhënies si edhe aktivitete stimuluese të studentëve.</p> <p><i>Gjithsesi, lind nevoja që pedagogët të përdorin platforma plotësuese të kontrollit të plagjiaturës si “Turnitin, Grammarly, etc.” për grupe ushtrimesh praktike, projekte individuale dhe në grupe si edhe kontrollin antiplagjaturë.</i></p> <p>Përdoren gjatë mësimdhënies metoda moderne bazuar edhe në politikën për të mësuarit [evidenca 17]. Sallat janë të një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e seminareve, diskutimeve apo për prezantimin e projekteve [Vizitë në kampusin e universitetit] [evidenca 2, 23.1].</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia përgjegjëse përdor mekanizma të ndryshëm të vlerësimit të stafit të angazhuar në programin e studimit siç është raporti në lidhje me vlerësimin e studentëve për lëndët [evidenca 23.1], formulari i vlerësimit të studentëve për lëndët, vlerësimi i mësimdhënies kolegë me kolegë, raporti mbi transparencën dhe krahasueshmërinë e vlerësimit dhe formulari i punës semestrale [evidenca 11.1, 11.1.2, 11.2.1, 11.2.2].</p> <p><i>Do të ishte e sugjeruar që si aneks të vendosen edhe shembuj konkrete të këtyre raporteve.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni përcakton ngarkesën mësimore vjetore për çdo fillim viti akademik kjo i jep mundësinë departamenteve të marrim masa në koordinimin dhe përmirësimin e mësimdhënies duke caktuar pedagogët më të përshtatshëm për lëndët dhe duke hapur vakanca të reja nëse lind nevoja [evidenca 20]. Ndër strukturat të cilat bashkërendojnë punën për të garantuar cilësinë e mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, si një ndër njësitë ndihmëse akademike pranë UniBa, e cila bën monitorim, vlerësimin dhe zhvillimin e përmirësimit e cilësisë. Ky monitorim zhvillohet me anë të kontrolleve periodike të strukturave drejtuese, sipas përcaktimeve në Statut [evidencat 1.2 & EV557C]. - Njësia kryesore përgjegjëse për programin “Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë” mbështet zhvillimin e mësimdhënies nëpërmjet metodave inovative dhe shërbimet IT siç parashikohet në manualin e TIK [evidenca aneksi 13]. - Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie që përfshijnë leksione të hapura, përfshirje të studentëve në seminare akademike, studime të rasteve praktikë, diskutime në grupe, mësim i bazuar në projekte, hulumtime, etj
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Theksohet se për këtë standard, institucioni i përmbush kriteret e akreditimit bazuar në evidencat e gjetura.</i></p>

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Sipas RVB dhe konstatimeve gjatë vizitës, UniBa bën përpjekje serioze të jetësojë lidhjet me institucione të tjera dhe ente kërkimore shkencore. Grupet kërkimore të krijuara në të gjithë universitetin, duke përfshirë edhe antarët e departamentit. Këto të fundit, nën drejtimin e Kordinatorit për Kërkim dhe Inovacion dhe Zv. Rektorit për Kërkimin e Aplikuar dhe Inovacionin, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e strategjive kërkimore dhe shtyllave kërkimore të universitetit, si dhe në aplikimet për grante evropiane dhe të tjera të financuara nga jashtë në nivel institucional [evidenca 37].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Duhet theksuar se nisur nga natyra e këtij programi studimi, njësia përgjegjëse për këtë program studimi ka mundësi të angazhojë studentët në projekte apo studime të ndryshme dhe nga sa më sipër ka nevojë për një angazhim më të lartë të studentëve. Por nisur nga numri i vogël i studentëve kjo situatë është e kuptueshme, ku gjithashtu kanë ndikuar dhe strategjitë e projekteve ku më së shumti janë të natyrave teknologjike pas COVID-19. Gjithësesi, duhet vlerësuar se në përmbajtjen e kurrikulës së këtij program studimi studentët kanë mundësi të specializohen në Hartimin dhe Menaxhimin e Projekteve.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit duket që ka marrë masa për të përmirësuar programin e studimit me futjen e tre lëndëve të reja në vitin 2020 i cili përkon edhe me periudhën e pandemisë [evidenca 2.1]. Në këtë kontekst mund të thuhet se studentët kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre kërkimore dhe ato të menaxhimit të projekteve.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Nisur nga kurrikula dhe përmbajtja e programit, një program i tillë master është i rëndësishëm për shtetin Shqipëtar në kushtet ku ai ndodhet, ato të proceseve të vështira të integritit dhe harmonizimit të legjislacionit. Siç tregojnë edhe evidencat e vëna në dispozicion, të gjithë studentët e diplomuar janë të punësuar në fushën e specializimit dhe në përputhje me diplomën [evidenca 30, tabela 24].
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të	NA

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përkrahje plotësisht	Përmbushje pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Departamenti i përgjegjës për programin e studimit i ka të përcaktuara në rregullore të programit mënyrën e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit, formën e kontrollit të dijeve sic është prova finale [evidenca 1, 1.2, 2 & 3]. Forma e vlerësimit është e parashikuar në çdo program të lëndëve [evidenca 2]. Në përgjithësi forma e kontrollit është e bazuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi i ndërmjetëm – 20% • Pjesëmarrja dhe aktivizimi – 10% • Detyra e Kursit – 20% • Provimi përfundimtar (i detyrueshëm) – 50% <p><i>Sugjerohet që neni 7 i rregullores të programit të reflektohet bazuar në ndryshimet e kuadrit ligjor që ministria ka përcaktuar se fundmi.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Të gjithë studentët marrin programet mësimore në fillim të semestrit. Kështu, para vlerësimit përfundimtar studentët kanë përfunduar një numër vlerësimesh të tjera [evidencat 2, 11.7.2].</p> <p>Në këtë program studimi, pedagogu titullar i lëndës para fillimit të çdo semestri informon studentët për tematikat që do të zhvillohen, qëllimin si dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve kjo bëhet nëpërmjet shpërndarjes së programit të lëndëve (syllabusit) i cili shpërndahet edhe elektronikisht. Sipas kursit, lloji i testimit ndryshon: me shkrim, me gojë, apo me shkrim dhe me gojë [evidencat 2, 3, 11.7.2].</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për sa më sipër vlerësohet se programi është i organizuar në përputhje me të gjitha standartet e parashikuara të programeve të ciklit të dytë të studimeve dhe rregulloret e posaçme të testimit dhe vlerësimit të dijeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përkrahje plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3




Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i studentëve lidhur me dijet, njohuritë e marra dhe aftësitë profesionale për secilën prej lëndëve zhvillohet i ndarë në dy faza sipas përcakimeve të syllabusit: <ul style="list-style-type: none"> - kontrolli përgjatë procesit mësimor nëpërmjet pjesëmarrjes dhe aktivizimit i cili ka pëshën afërsisht 10% të vlerësimit total të lëndë, ku kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentit në leksione, seminare, detyra kursi dhe provime ndërmjetëse, etj. - kontrolli i fazës së dytë përfshin kontrollin nëpërmjet provimit përfundimtar i cili sipas përcaktimeve të programeve të lëndëve (syllabuseve) të vëna në dispozicion është i detyrueshëm pavarësisht pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë [evidenca 2].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sipas evidencave të parashtruara vlen të theksohet që UniBa ka një sistem administrimi për studentët që është Platforma e Studentit dhe platforma Classroom – e përdorur përgjatë mësimdhënies online [evidenca 5.1, 23 & 23.1]. <i>Ritheksohet, siç u sugjerua më sipër, angazhimi i universitetit në një sistem që mat plagjiaturën e punimeve të studentëve.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi i lëndëve është në përputhje me kuadrin institucional dhe atë ligjor shqiptar VKM nr. 41, datë 24.1.2018 (i ndryshuar). Këto element të vlerësimit parashikohen në syllabusin e secilës prej lëndëve.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Stafi akademik i këtij programi studimi informon studentët për rezultatet e provimit, proces i cili realizohet dhe me mbështetjen e zyrës së sekretarisë mësimore të UniBa-së sipas nenit 20 të rregullores së programit [evidenca 3]. Kjo rregullore parashikon edhe dorëzimin e procesverbalit të vlerësimit përfundimtar nga pedagogu i lëndës siç parashikohet në nenin 21. Studentët kanë të drejtë të njihen me tezën e provimit, të kërkojnë informacion apo shpjegim më të detajuar në lidhje me vlerësimin dhe të paraqesin ankesa për këtë proces, siç parashikohet në nenin 89 të rregullores akademike [evidenca 1.2].
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse, duke filluar nga njësia bazë përgjegjëse për këtë program, ndjekin rregulla dhe metodika të ndryshme të kontrollit të plagjiaturës. Në raste të ndryshme të konstatimit mund të merren masa administrative disiplinore siç parashikohet në rregulloren e programit neni 31 [evidenca 3]. UniBa ka adoptuar edhe Kodin e Etikës i cili është i zbatueshëm detyrimisht nga studenti dhe i parashikuar në programet e lëndëve [evidenca 2].

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas të dhënave, institucioni u siguron studentëve marrjen e informacionit në kohë, bazuar edhe në parashikimet e kuadrit rregullator të institucionit [evidencat 1.2 & 11.8]. Rezultatet i dorëzohen sekretarisë mësimore dhe studentët mund të aksesojnë ato në sekretarinë mësimore dhe të fillojnë procedurat e ankimit sipas parashikimeve.			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Mbas shpalljes së rezultateve të provimit dhe dorëzimit në sekretarinë mësimore, studentët kanë mundësinë e leximit të notës së tyre në sistem ose marrjes së rezultatit në sekretarinë mësimore dhe ankimit brenda 48 orësh, ankim i cili i paraqitet departamentit. Në vijim studentët kanë të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi nga ana e pedagogut, i cili është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me komentet. Në rastet kur kjo është e pamundur, shefi i departamenti ja përcjell këtë ankesë dekanit i cili ngre një komision <i>ad hoc</i> që bën verifikimin e pretendimeve. Vlerësimi i komisionit për provimin përfundimtar ose përsëritjen e provimit i dorëzohet sekretarisë mësimore të Dekanit siç parashikohet në procedurën e ankimit [evidenca 1.2, neni 89-90, 15, 11.8].			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Ky standard i përmbush kriteret e vlerësimit për sigurimin e një vlerësimi të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën dhe procesin e vlerësimit. Lind nevoja e institucionit të angazhohet për të adoptuar një mekanizëm të kontrollit të plagjiaturës.			
Konkluzione	Ky standard i përmbush kriteret e vlerësimit për sigurimin e një vlerësimi të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën dhe procesin e vlerësimit. Lind nevoja e institucionit të angazhohet për të adoptuar një mekanizëm të kontrollit të plagjiaturës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Planet mësimore dhe programet e lëndëve kanë synim kryesor aftësimin teorik dhe praktik të studenteve. Lëndët ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë jepen njohuri të përgjithshme, dhe në pjesën e dytë jepen njohuri të veçanta duke përfshirë në disa raste edhe elementë kërkimorë. Departamenti përgjegjës përfshin në analizën vjetore edhe atë të syllabuseve, sipas procedurave përkatëse dhe në kohë të mjaftueshme përpara fillimit të procesit mësimor. Syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka të paktën gradën “Doktor i Shkencave” [evidencat 2,3 & 30, tabela 9].
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit garanton zhvillimin e dijeve në fushën teknologjike dhe ato të komunikimit nëpërmjet zhvillimit të aftësive kritike të mendimit, prezantimit, aftësive komunikuese, shkrimit të projekteve me anë të lëndës së futur rishtazi “Hartim dhe Menaxhim i Projekteve” dhe

	2 lëndëve të metodave të kërkimit shkencor [evidenca 2, 2.1 evidenca 30, tabela 9].		
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Përgjatë programit, lëndët ndërlidhen me njëra tjetrën në kuptim logjik drejt thellimit dhe specifikimit të dijeve, duke ofruar kryesisht lëndë të përgjithshme në tre semestrat e parë, e në vijimësi lëndë më të specializuara. Në fund të lëndës testohen aftësitë e fituara nga studenti nëpërmjet testimit me shkrim ose me gojë, një temë projekti, rezultatet nga udhëheqesi i praktikës profesionale. Të gjitha këto grumbullohen në kompetencat e aftësitë personale të studentit me finalizimin e temës së diplomës [evidencat 2, 2.3, 13.1, 13.2].		
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Një nga komponentët e kurrikulës së programit është praktika profesionale ku caktohet një pedagog përgjegjës për ndjekjen e punës së studentëve në këto praktika ku studentit i kërkohet të plotësojë ai dhe përgjegjësi direkt gjatë praktikës një sërë formularësh [evidenca 2.3]. Puna e një studenti kulmon me provën finale, punimin e temës së diplomës dhe mbrojtjen e tyre përpara një komisioni të ngritur nga përgjegjësi i departamentit [evidencat 2.2, 2.2.1, & 13.2]. E vetmja formë e bashkëpunimit me institucionet e tjera në ndërthurjen e formave të mësimdhënies mbetet praktika profesionale ku studentët kanë mundësinë e shkëmbimit dhe marrjes së një eksperience në praktikë dhe ftesa e leksioneve të hapura të organizuara nga departamenti dhe institucioni [evidenca 32].		
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Çdo vit akademik përcaktohet një kalendar i aktiviteteve si në rang departamenti ashtu edhe në rang institucioni, të cilat organizohen edhe nga lektorët e brendshëm dhe ata të ftuar. P.sh., mund të përmendet aktiviteti i natyrës së leksionit të hapur i mbajtur nga Asoc. Prof. Zamira Çavo me tematikë “E Vërteta në kohën e internetit” [evidenca 32]. <i>Sugjerohet nevojshmëria e organizimit të më shumë aktiviteteve në institucion si edhe e vizitave studimore në institucione të tjera.</i>		
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Me kampusin e ri UniBa ofron evidenca për iniciativat inovatore që ka ndërmarrë në krijimin e një universiteti sipas konceptit të “open space university”. Kjo vërehet edhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit [evidenca 1.3]. <i>Sugjerohet që institucioni të rrisë përpjekjet për të përthithur fonde nga vendi por dhe nga burime të huaja me fokus projektet e shkëmbimeve ose të natyra kërkimore shkencore.</i>		
Konkluzione	<i>Standardi në lidhje me garantimin dhe rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke përfutur kompetenca profesionale e shkencore është i përmbushur.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Detyrimet përmbyllëse si një nga komponentët e programit i cili ka 18 kredite evropiane, janë konform kriterëve të parashikuara në kuadrin rregullator [evidenca 2]. Në rregulloren akademike të institucionit janë përcaktuar qartë detyrimet që institucioni ka në përmbyllje të studimeve. Neni 98 i rregullores akademike dhe neni 16 i rregullores së programit parashikojnë qartë se studentët duhet të paraqesin kërkesat me propozimet për temat e propozuara dhe udhëheqësin. Një proces përgjatë secilit studentët do të njihen dhe me Paketën e Provës Finale [evidencat 1.2, 2.2 & 3].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Në Paketën e Provës Finale është e përcaktuar qartë se cilat janë përgjegjësitë dhe detyra e udhëheqësit dhe palëve të tjera siç janë komiteti shkencor, etj., [evidenca 2.2, kreu 2]. Në bazë të rregullores vërehet edhe ngritja e komisionit shkencor të vlerësimit të provës finale [evidenca 1.2, neni 100 & evidenca 13.2]. Ngritja e këtij komisioni bëhet me vendim të dekanit dhe propozim të përgjegjësit të departamentit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i ngritur nga dekanit bën vlerësimin e temës së diplomës. Komisioni përbëhet nga udhëheqësi shkencor i temës dhe dy pedagogë me gradën shkencore doktor ose më titull akademik, të cilët bëjnë vlerësimin final të temës dhe mbrojtjes së bërë nga studenti pasi udhëheqësi shkencor ka bërë vlerësimin e tij paraprak [evidencat 2.2.1 & 13.2].
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i Diplomës kontrollon në mënyrë të imtësishme punën e secilit student duke dhënë vërejtje me shkrim për çdo fragment pune si dhe sugjeron literaturën e nevojshme për t'u konsultuar më qëllim arritjen e një produkti të thelluar studimesh. Pedagogët që udhëheqin studentët për të përgatitur tezën përfundimtare janë njohës të mirë të fushës, me eksperiencë në akademi dhe me aktivitet kërkimor e botues. <i>Lind nevoja që pas paraqitjes përfundimtare të bëhet edhe një kontroll antiplagjaturë, dhe më pas udhëheqësi të miratojë mbrojtjen e tezës e tezës [evidenca 2.2 & 2.2.1].</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamentet asiston studentët në hartimin e diplomës dhe në kontrollin e literaturës brenda fushës së studimit. Pedagogët punojnë ngushtë me studentët për aftësimin e tyre në metodat e kërkimit shkencor.

	Studentëve iu vihen në dispozicion mjediset e Universitetit si dhe te institucioneve te tjera publike apo private me te cilat UniBa ka marrëveshje me qëllim mbështetjen e punës së tyre kërkimore.								
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët mund të mbrojnë tezën e tyre vetëm nëse i kanë kaluar të gjitha kurset, siç është parashikuar në rregulloren akademike të universitetit. Studentët vlerësohen nga një komision prej tre personash që janë anëtarë të departamentit dhe të fakultetit [evidencat 1.2 & 2.2].								
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Diploma shoqërohet me suplementin e diplomës. Suplementi i diplomës hartohet ne përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, si është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimeve te Studentëve (QSHA). Suplementi i Diplomës jep gjithë informacionin e kërkuar për programin MSH në “Studime Evropiane” me profi “Politika Evropiane dhe Administrim Publik”, si dhe rezultatet e të nxënit dhe aftësitë që merren me përfundimin e secilit program [evidenca 2]. Në përfundim të programit të studimit, nëse mbrohet me sukses teza, studentit merr një kopje zyrtare të programit të studimit. Për më tepër, brenda një afati të përcaktuar ligjor, studentët marrin gjithashtu diplomën e shoqëruar me suplementin e diplomës [evidenca 13.2].								
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan dokumentacionin e studentit dhe paraqet informacion për çdo student nëse kërkohet. Zyra e Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e Arkivës janë pajisur në përputhje me standardet specifike të funksionimit të saj dhe përmbushin të gjitha kriteret për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit [evidencat 19.2 & 24].								
Konkluzione	<i>Për sa më sipër, institucioni ndjek procedura të qarta të detyrimeve përmblyëse dhe përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm. Ky standard i përmbush kriteret e akreditimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo	X			
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo						
X									

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjediset brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA

Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA		
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	NA		
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve	Nga shqyrtimi i RVB-së, dosjeve të personelit akademik, takimi me stafin akademik dhe me personelin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, rezulton se UniBa ka personel akademik që përmbush standardet e cilësisë dhe kriteret ligjore për mbulimin e këtij programi. Gjatë periudhës 2019-2022, Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit që angazhohet në realizimin e programit të studimit ka 7 PAE (1 Prof.Asoc.Dr. + 2 Dr. + 4 Msc.).

<p>mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në këtë program studimi gjatë vitit 2019-2020 janë angazhuar 6 pedagog nga të cilët: 1 me titullin Prof.Asoc dhe 5 Doktor Shkencash. Në vitin 2021-2022 programi për realizimin e këtij programi studimi u angazhuan 8 pedagog nga të cilët 1 me titullin Prof.Asoc; 5 Doktor Shkencash dhe 2 MSc.</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022 vërehet se nga 9 pedagog të angazhuar për plotësimin e nevojave të këtij programi studimi 3 janë me titullin Prof.Asoc; 5 Doktor Shkencash dhe 1 MSc (evidenca 30).</p> <p>UniBa përcakton se stafet akademike marrin me përparësi module të profilit të tyre akademik, kjo gjë ju mundëson të profilizohen në një drejtim dhe të sigurojnë nivel të lartë kualifikimi (evidenca 11.5.2).</p> <p>Nga komunikimet e GVJ me pedagogët dhe studentët, si dhe përshtypjet e studentëve rezultojnë nje vlerësim shumë i mirë për stafin akademik (Vizita në institucion).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi akademik respektonte 3 module në semester, duke mos zhvilluar më tepër se dy module me të njëjtin grup studentësh, sipas rregullit të vendosur në UniBa. Ngarkesa e personelit akademik efektiv përfshinte, jo vetëm ngarkesën mësimore, e cila përbën rreth 50% të ngarkesës së punës, punën shkencore me rreth 20% , punën administrative, punën me studentët dhe aktivitete që organizonte UniBa me rreth 30% të volumit të punës së personelit akademik efektiv. Manuali i MBNJ përcakton normën prej 360 orë minimale në auditor. (evidenca 11.5.2). Personeli akademik efektiv i departamentit mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Për periudhën e akreditimit, dëshmohet qëndrueshmëri e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit. Dosjet e personelit të vena në dispozicion gjatë takimit me ZMBNJ përfshijnë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë personelin akademik (evidenca 7.1).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni bazohet në dokumenta si: Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Udhëzimet e Rektorit për Rekrutimet për të zhvilluar dhe ndjekur procedura të rregullta rekrutimi dhe vlerësimi për stafin (evidenca 7 & 11.5.1). Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për zbatimin e kritereve në rekrutimin dhe vlerësimin e stafit akademik, që nga kriteret e përgjithshme: a) Diplomë e ciklit të parë dhe të dytë sipas fushës akademike, deri tek kriteret specifike sipas rastit të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të UniBa. Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e publikon shpalljen për vendet vakante, duke specifikuar nivelin e kualifikimit, detyrat e vendit të punës, dokumentacionin e kërkuar, që garantojnë përzgjedhjen e personelit të kualifikuar (http://umb.edu.al/zyra-e-menaxhimit-te-burimeve-njerezore.html).</p>

	<p>Mbështetur në procedurën e përcaktuar në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore vlerësim dhe përzgjedhja e personelit kalon në katër faza.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në fazën e parë, kryhet shpallja e pozicionit të lirë të punës, 2. Në fazën e dytë vlerësimi me dosje duke krijuar një databazë të aplikantëve 3. Në fazën e tretë kryhet vlerësimi paraprak i aplikantëve nga një komision i përbërë nga Administratori, Sekretari i përgjithshëm, Drejtuesi i zyrës së mmenaxhimit dhe Administrimit të performancës 4. Në fazën e katërt intervista e ndarë në dy faza <ul style="list-style-type: none"> • takimi paraprak • intervista nga komisioni, intervista me gojë në prani të komisionit të ngritur. (evidenca 7) <p>Sa i takon procedurave të vlerësimit, ato kanë disa nivele që nga drejtuesi i Departamentit, ZMBNJ, personeli akademik, studentët dhe vetëvlerësimi që secili bën për përmbushjen e detyrimeve sipas disa shtyllave kryesore: shtylla akademike, e cila përfshinte të gjitha veprimtaritë e procesit të mësimdhënies; shtylla e kërkimit shkencor; shtylla e studentëve dhe marrëdhënieve me komunitetin; shtylla administrative dhe shtylla e sipërmarrjes: https://www.umb.edu.al/mps.html. GVJ gjatë takimit me ZMBNJ shqyrtoi vlerësimet e dosjeve të disa anëtarëve të stafit akademik dhe konfirmon aplikimin e procedurave të vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” ka lëndë të tilla si “Metodat cilësore të kërkimit” dhe “Metodat sasiore të kërkimit” të cilat janë realizuar në laboratorë me kompjutera. Institucioni ve në dispozicion stafin ndihmës për asistencën e stafit akademik dhe studentëve dhe mirëmbajtjen e City Lab.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij program studimi. Për secilin person të angazhuar në UniBa, Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore mbledh dhe administron dokumentacionin sipas formateve të unifikuara të Dosjes personale të stafit, i ka ato të ruajtura ndër vite, dhe specifikuat në semestra (evidenca 7.1 & 8). Këto të dhëna administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>

<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet e realizuara me drejtuesit e institucionit, studentët dhe shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se UniBa përfshin grupet e interesit, ku janë përfaqësues të administratës publike në nivel qendror apo vendor, biznese e organizata të shoqërisë civile, në të gjitha hapat e realizimit të programit të studimit dhe praktikat profesionale të studentëve (evidenca 15). Këto marrëveshje bashkëpunimi shtrihen që nga IAL homologe, përfshirë universitete publike e private deri tek institucionet publike, Bashkitë, dhe sipërmarrje private, brenda dhe jashtë vendit. Koordinator i departamentit mbikëqyr studentët në praktikat profesionale (ev 3.1). Duhet theksuar se Shtylla e Studentëve dhe Marrëdhëniet me Komunitetin përbën një nga komponentët kryesorë edhe të vlerësimit të performancës së personelit akademik në UniBa: https://www.umb.edu.al/mps.html.</p>		
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në manualin e praktikës profesionale të hartuar për, praktikat profesionale të ciklit të studimit master në UniBa, është e përcaktuar në formën e një formulari angazhimet e personelit mbikqyrës për realizimin e praktikës profesionale. Ky personel ka si detyrë vlerësimin e studentit për 20 tregues të përmbledhur në formular dhe asiston studentin në hartimin e raportit përfundimtar. (evidenca 2.3)</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik" përmbush standardet e cilësisë si për nga niveli i kualifikimit, përvoja në punë, qëndrueshmëria në këtë departament, në përputhje me fushën e programit, kërkesat ligjore dhe për garantimin e standardeve të mësimdhënies. Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka të përcaktuara qartë në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe mbështetës të angazhuar në këtë programi studimi. Koordinator i Departamentit bashkëpunon me institucionet për mbikëqyrjen e praktikave profesionale të studentëve.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të</p>	<p>Vizita e GVJ u krye në mjediset e reja të UniBa, Kampusi 2 i cili ndodhet në Rrugën Frang Bardhi dhe shtrihet në një sipërfaqe të shfrytëzueshme</p>

<p>përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>prej 6,451 m2 (evidenca 00 & 30). Ndërtimi i godinës së re në kampusin 2, sikurse dhe rikonstruktimi i godinës ekzistuese në këtë kampus, garantojnë kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” dhe lëndëve përkatëse. Mjediset janë të shumë të mira dhe të përshtatshme për klasa leksioni/seminari, zyra për stafin, biblioteka në funksion të zhvillimit sipas parametrave bashkëkohore të programit të studimit. Krahas tyre UniBa ofron edhe mjedise sportive dhe mbështetëse deri tek bare e restorante. Të gjitha këto mjedise u vizituan nga GVJ gjatë vizitës në institucion (evidenca 30; vizita në institucion).</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore infrastrukturore në Kampusin 2 ku zhvillohet programi i studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” janë të pajisura me teknologjinë e fundit dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, në përputhje me programin e studimit. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me smartboard dhe sisteme projektimi digjital dhe stafet akademike dhe studentët konfirmuan përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies në auditoret e UniBa. I gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjet wi-fi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, etj në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ (Vizita në institucion).</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” nuk parashikon orë laboratorike por lëndë të tilla si “Metodat cilësore të kërkimit” apo “Metodat sasiore të kërkimit” përdorin laboratorë me kompjutera për realizimin e tyre. Kushtet e mjedisit në UniBa janë të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të lëndëve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në mjediset e UniBa, GVJ konfirmon pajisjen e mjedisve me teknologjinë e nevojshme për sigurimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies maksimale. UniBa ka dy laboratorë të teknologjisë së informacionit në katin e parë, të aksesueshëm si nga stafi akademik edhe studentët, të cilët ata i përdorin gjatë lëndëve të ndryshme. GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të</p>	<p>Kapacitetet e UniBa dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. Mjediset mësimore si klasa, auditorë e laboratorë mundësojnë realizimin e procesit mësimor.</p>

<p>mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Nga vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i auditorëve, laboratorëve, programeve të reja kompjuterike, bibliotekës gjatë vizitës u konstatua se mjediset mësimore dhe ato ndihmëse janë të pajisura me lidhje interneti dhe me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit duke siguruar përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies / mësimnxënies në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimoretiorik dhe praktik mësimor.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se UniBa vë në dispozicion mjedise mësimore dhe kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". Stafit akademik dhe studentët konfirmuan përdorimin e metodave dhe teknologjisë bashkëkohore të mësimdhënies në auditoret e UniBa.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse që vihet në dispozicion të programit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik" është në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. GVJ shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lëndëve të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion për marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Literatura gjendet si në formë fizike ashtu edhe në formë digjitale. Totali i titujve të vënë në dispozicion për studentët është 8.985 tituj dhe fondi pasurohet vazhdimisht. (evidenca 25 & 25.1)</p> <p>Gjatë vizitës GVJ u njoh me hapësirën e titujve të librave për fushwn e studimeve europiane dhe konfirmoi që janë në shërbim të natyrës së lëndëve që zhvillohen në këtë program.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në çdo viti akademik Departamenti propozon një listë të përditësuar me libra për bibliotekën, që janë të përfshirë në literaturën e programit mësimor Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik" (evidenca 25.1). Pavarësisht pasurimit periodik të fondit të bibliotekës, ajo ka nevojë të shtojë librat fizikë të botimeve të fundit në Studime Europiane, si nga autorë vendas apo edhe përkthime.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UniBa ndodhet në katin e 1-rë të Kampusit 2 me një hapësirë 27.3 m² e cila zgjerohet me një hapësirë tjetër prej 95.1 m² në të cilën janë të arkivuara revistat e punime shkencore. Në katin përdhe ka një hapësirë prej 70 m² e pajisur me 28 vende me kompjutera për aksesimin në bibliotekat dixhitale. Përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambjentëve të brendshme dhe të jashtëme të saj, institucioni garanton të drejtën e çdo studenti për aksesim të bibliotekës. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit pasi e gjithë hapësira e bibliotekës ka wi-fi. Biblioteka garanton mundësi për të gjithë me kompjutera për aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UniBa është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj, në përputhje me natyrën e programit të studimit (evidenca 25). <i>GVJ sygjeron që Biblioteka të pasurohet me botime të viteve të fundit si nga studiuesit shqiptarë dhe të huaj në fushën e studimeve Europiane, të cilat duhet të vendosen edhe në syllabuset e lëndëve për të mundësuar plotësimin e lëndëve me literaturë të 5 viteve të fundit gjë që në një pjesë të tyre mungon. GVJ rekomandon shtimin e titujve fizik në gjuhë të huaj dhe vendase të cilat janë publikuara gjatë pesë viteve të fundit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UniBa u krijon kushte studentëve, sikurse edhe stafit akademik, për të aksesuar pa pagesë bibliotekat online si bibliotekat dixhitale EconBiz, JSTOR, Ebsco Open Dissertation, si dhe Springer, ku mbulohen të gjitha fushat e shkencës e teknologjisë. (evidenca 25 & Vizita në institucion.).</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët e programit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". Gjithashtu, menaxhimi i librave në bibliotekë realizohet përmes Platformës digjitale të menaxhimit të librit.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-19.45. Kërkesat për libra nga studentët dhe personeli kryen në harkun kohor 8.00-16.30. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërheqin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. (vizita në institucion) Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shrytëzonin bibliotekën gjatë hapsirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online</p>	<p>Pasurimi i fondit me literaturë dhe rritja e aksesimit në bibliotekat online është politik e UniBA. Drejtuesi i njësisë bazë bashkëpunon me punonjëset e bibliotekës për monitorimin e vazhdueshëm të shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët e programit të studimit.</p>

<p>(titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat e dëshmonin shakallën e mjaftueshme të shfrytëzimit.</p> <p>Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave të kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për lëshimin/kthimin, vonesat apo dëmtimin e librave.</p> <p>Fondi digjital që është në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi është tejet i pasur. Titujt e artikujve në bibliotekat online si bibliotekën dixhitale EconBiz https://www.econbiz.de (rreth 200 mijë artikuj studime evropiane); JSTOR (books and journals) https://www.jstor.org (rreth 180 mijë artikuj politika e BE); Ebsco Open Dissertation https://biblioboard.com/opendissertation (rreth 4.5 mijë disertacione studime evropiane); si dhe Springer https://link.springer.com (rreth 19 mijë artikuj dhe libra për politikën evropiane); (evidenca 25)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vizitoi Bibliotekën, shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lëndëve të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion për marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Bibloteka e UniBa është e pajisur me literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe të huaj në përputhje me natyrën e programit të studimit, të cilat plotësohen nga aksesit në platformat digjitale që janë të aksesueshme pa pagesë si për stafet akademike dhe studentët. Mjediset mbështetëse të bibliotekës, kompjuterat, aksesit në internet kapërcejnë kufizimet e fondit fizik të burimeve të informacionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UniBa ka hartuar një udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit. Ky dokument është në funksion të menaxhimit të të dhënave, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe gjithë procedurat e rregullat dhe politikat përkatëse. Ai përmban çështje si Portali Studentor, Sistemi i menaxhimit të të dhënave të studentëve SIS Classter, Google Classroom, Intranet dhe GSuit për komunikim të brendshëm, webfaqja zyrtare e UniBa dhe nënfaqet e grupit Barleti. Sistemi mundëson informimin në kohë reale të studentëve lidhur me</p>

	<p>rezultatet e tyre dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën për të gjithë procesin.</p> <p>Gjatë takimeve në institucion, GVJ konfirmon vlefshmërinë e platformës e portalit studentor LMS e Classroom që ju mundëson studentëve të informohen në kohë reale lidhur me aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim (evidenca 23). GVJ gjatë takimit me sekretarinë mësimore konstatoi se UniBa zbaton administrimin e informacionit në mënyrë korrekte.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi Intranet mundëson komunikimin e brendshëm, informacionin dhe materialet që lidhen me procesin mësimor ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në kohë reale. Ky sistem mundëson lehtësira si për studentët pasi ata informohen mbi rezultatet e testimit, njoftime, materialet e lëndëve etj ashtu edhe për stafin akademik që dokumenton punën e tij përmes sistemit. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që menaxhohet dhe administrohet nga ky system është dhe veprimtaria e sekretarisë mësimore duke plotësuar bashkëpunimin e të tre komponentëve Student/sekretari mësimore/personel akademik. GVJ konfirmon funksionimin e këtij sistemi të brendshëm të menaxhimit të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. (evidenca 23 & 44)</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UniBa përmes sistemit të menaxhimit që përdorë, në bazë të programeve të studimit mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët. Për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit sigurohet akses i dedikuar nëpërmjet logimit me kredencialet personale, si në intranet, ashtu edhe në platformat online. Përmes sistemit G Suit, Intranet institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Përdormi në nivel institucional i këtij sistemi mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se format e mbështetjes së sistemit për personelin akademik ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Publikimi online i kurrikulës së programit të studimit, - Monitorimi i planit mësimor, - Regjistrimi në sistem i personelit akademik përgjegjës për lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor, <p>Raportimi mbi ecurinë e plotësimit të afateve të përcaktuara në Manual Format e mbështetjes për studentët ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngarkimin e detyrave të kursit, - Ngarkimin e projekteve - Marrjen e leksioneve të ngarkuara nga personeli akademik - Marrjen e vlerësimeve


	<p>Personeli ndihmës akademik ndihmon studentët duke ju vënë në dispozicion një sekretari online në kohë reale dhe nga çdo vend, për t'iu bërë të ditur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grafikon e provimeve - Notat e provimeve - Lajmërimet apo informacione të dërguara nga pedagogët apo departamenti
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në veçanti gjatë viteve të pandemisë Covid-19 përdorimi i platformave dhe aktiviteti mësimor u zhvillua online (në platformat google classroom), ku studentët gjetën informacionin për lëndët, modulet dhe literaturat përkatëse. Përdorimi i platformave bëri të mundur rritjen e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit si për stafin dhe për studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi I Portalit Studentor kontrollon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Autenticitetin e informacionit identifikues të përdoruesit; - Autorizon aksesin e përdoruesit në të gjitha funksionet/operacionet; - Ruan privatësinë e të dhënave. <p>Nëpërmjet këtij sistemi institucioni mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Me të dhënat reale të grumbulluara mund të hartohen raporte monitorimi rreth performancës së procesit mësimor si nga personeli akademik, ndihmës por edhe pjesmarrjes së studentëve në frekuentimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. Të dhënat e grumbulluara iu vihen në dispozicion titullarëve të njësisë kryesore edhe të njësisë bazë. Nga databaza e krijuar krijohet një panoramë e qartë rreth hedhjes në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e kriterëve të vlerësimit dhe respektimin e afateve të hedhjes së rezultateve online. Sistemi Portali Studentor ka aksesin e tij nga faqja zyrtare e internetit të UniBa.</p> <p>Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit si më sipër, garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet dhe autoritetet drejtuese. Ky përbën edhe një avantazh të UniBa të përmendur nga studentët dhe sekretaria gjatë takimeve të GVJ në institucion.(evidenca 44)</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ kontrolloi informacionin e disponueshëm te faqja online të UniBa www.umb.edu.al dhe konfirmon se ajo është e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët, personelin akademik dhe gjithë personat e interesuar mbi programin e studimit dhe aktivitetet e ndryshme. Kjo faqe online është edhe në gjuhën angleze: https://umb.edu.al/en/fakultetet-dhe-qendrat.html</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UniBa disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Si për stafin, ashtu edhe për studentët, përmes këtyre platformave janë</i></p>

	<i>mundësuar forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit, duke siguruar informacionin në kohë reale. Faqja online e UniBa është edhe në gjuhën angleze, e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët, personeli akademik dhe publikun e interesuar. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Raportet me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve hartohen çdo vit përmes një strukture të veçantë si Zyra për Financën. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Të ardhurat kryesore vijnë nga pagesat e studentëve të UniBa. (evidenca 28 & 28.1).
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit i njësisë bazë, Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, përfshihet në planin e përgjithshëm të institucionit, i cili përmban të dhëna mbi burimet njerëzore, që zenë peshën më të madhe specifike të shpenzimeve, krahas shpenzimeve operative, për bibliotekën dhe detyrimet financiare e grantet (evidenca 28). Nga Raporti Financiar Vjetor dalin qartë të dhënat mbi Strategjinë, misionin dhe objektivat e institucionit, referuar aspekteve ekonomike në funksion të realizimit të të gjitha programeve të studimit, ku përfshihet edhe ai i programit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik”. (evidenca 28.4).
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni ka krijuar njësinë e auditimit të brendshëm në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Raporti i përvitshëm i Auditimit të Brendshëm ku dokumentohet situata financiare shërben që të vlerësohet efektiviteti financiar i UniBa, bazuar në balancën midis të ardhurave dhe shpenzimeve i cili i dërgohet Bordit të Administrimit të UniBa (evidenca 28.2). Auditimi i Jashtëm për periudhën e akreditimit kryhet nga kompania audituese ndërkombëtare “Grant Thornton” (evidenca 28.3).

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Zyra e Financës së UniBa harton bilanci financiare vjetore në përputhje me aktet ligjore dhe të gjitha njësitë bazë, si dhe Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, informohen për indikatorët kryesorë. Treguesit financiarë si dhe zbatimi i buxhetit bëhen pjesë e analizës në Bordin e Administrimit (evidenca 28.4).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UniBa i siguron burimet e financimit nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konsulencat, shërbimet • Tarifa për dhe gjatë shkollimit, • Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm), • Të tjera (qera, ndryshime të kursit valuator, interesa bankare), • Donacionet dhe projektet (evidenca 28) <p>Referuar RVB-së, UniBa siguron qëndrueshmëri financiare për gjatë gjithë kohës që zhvillohet program i studimit. GVJ, bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qëndëruar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucion. Nga pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, opinionet dhe sugjerimet e Bordit të Administrimit, rezultojnë se UniBa nuk ka përdorur rritjen e tarifave të studentëve si një ndërhyrje të posaçme për të rritur të ardhurat financiare. (evidenca 30).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UniBa garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit përmes tarifave studentore, projekteve dhe të tjera. Zyra e Financës përgatit periodikisht raportet financiare vjetore. Audit i brendshëm shoqërohet edhe nga audit i jashtëm që konfirmojnë qëndrueshmërinë financiare të UniBa. Burimi parësor i financimit të UniBa vjen nga tarifat e studentëve të të gjitha programeve të studimit. Si mjet për të reduktuar kostot e personelit që përbëjnë edhe shpenzimet më të mëdha është zbatuar shtrirja horizontale e ngarkesës së tyre duke dhënë mësim në disa departamente e programe studimi dhe pjesëmarrja në projekte. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	
--	-----------------------------	----------------------------	---	--




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UniBa, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka përcaktuar politika e procedura si në nivel institucioni ashtu edhe rregullore të programit të studimit, që mbulojnë si kriteret për pranimin e studentëve, ashtu dhe ato për kalimin nga njëri vit tek tjetri, përgjatë një cikli të plotë akademik të studimeve masterr (evidenca 1 & 2 & 3).</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” zhvillohet në përputhje me rregulloren e vet përkatëse, në rregulloren e UniBa, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen qartë të gjitha njësitet, rolet dhe përgjegjësit përkatëse për mbarëvajtjen e plotë të programit. Kjo rregullore i bashkangjitet dokumentave të tjera të UniBa dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t’u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni, (neni 2).</p> <p>Në nenin 4 të Rregullores së UniBa, përcaktohet se, “studenti është një ndër 5 shtyllat e aktiviteteve kryesore”. Shtylla, studentit në qendër përfshin organizimin dhe bashkëpunimin e njësive të angazhuara në proceset që zhvillohen në mbështetje të studenteve. Kjo fillon që nga njohja e tyre me UniBa deri tek pranimi, regjistrimi, angazhimi në jetën studentore dhe komunitare, mbështetja në përparimin profesional, dhe në karriere, etj. Nga dokumentacioni dëshmohet ekzistenca dhe funksionimi strukturave të dedikuara si; Zv. Rektori për çështjet studentore i cili menaxhon zyrat si më poshtë: Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit; Dekani i Studenteve dhe vet organizimin studentor; Zyra e Alumnit dhe Karrierës. (evidenca 2)</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, GVJ konstatoi se institucioni respekton rregullat që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar rregullores së institucionit, të programit të studimit dhe evidencave të tjera shoqërues strategjik dëshmojnë se një ndër parimet e funksionimit të UniBa lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student të programit të studimit. Procedurat e aplikimit në UniBa janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit në faqen online: http://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html Nga biseda me studentët,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascabal



	GVJ vlerëson se të gjithë studentët ishin të kënaqur me mjedisin mbështetës në UniBa nga hyrja në dalje. Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit të studentëve që kryen procesin e regjistrimit, respekton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë. Edhe studentët ekzistues të programit të studimit konfirmojnë se procedurat janë të qarta dhe të zbatueshme për të gjithë dhe koordinatori i Departamentit (staf akademik) së bashku me stafin administrativ të sekretarive është shumë ndihmues për ta.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Institucioni dëshmon se harton dhe publikon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. Ato janë lehtësisht të aksesueshme në faqen e internetit dhe bëhen me dije pranë zyrës së pranimit dhe informimit të studentëve. Këto kritere publikohen në dokumente të veçant sikurse bëhen me dije edhe në faqen zyrtare të UniBa http://umb.edu.al/pranimet.html . Kriteret e pranimit të studentëve propozohen nga njësia bazë dhe miratohen me vendim senati. Në fillim të çdo viti akademik, shpërndarja e këtij informacioni kryhet me mjete dhe mënyra të ndryshme komunikimi si: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Broshurat, fletëpalosjet; ➤ Publikimet në rrjetet sociale; ➤ Web-in zyrtar të UniBa; ➤ Ambientet fizike të institucionit; ➤ Mediave të ndryshme televizive; (evidenca 18-19)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni i ka të përcaktuara qartë kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin Master, të shpallura e të kuptueshme në faqen online. Krahas të dhënave që jepen në RVB-në e programit të studimit dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konfirmoi ekzistencën e kritereve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion, ku aksesueshmëria e të gjithë informacionit që lidhet me procedurën që nga pranimit dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga studentët dhe publiku.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kritereve të përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Kriteret e pranimit janë të shpallura e publike për të gjithë të interesuarit në faqen online UniBa: http://umb.edu.al/pranimet.html . UniBa vë në dispozicion të të interesuarit nëpërmjet faqes zyrtare, mediave sociale, fletëpalosjeve në ambientet e institucionit që në hyrje, informacionin në lidhje me kriteret e programit të studimit në ciklin e dytë Master.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik politikat e rekrutimit në përputhje me standardet kombëtare dhe nuk ka kritere të veçanta për këtë program studimi. Lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, institucioni dëshmon se nuk aplikon kritere shtesë por

	zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it dhe mbështetje me bursa. (evidenca 00)			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik politikat e rekrutimit në përputhje me standardet kombëtare dhe parashikon kuota për studentët nga shtete të tjera. (evidenca 18.2)			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni harton politika të ndihmës ndaj studentëve në të gjitha planet, si për akomodime të atyre që vijnë nga jashtë Tiranës, edhe ndihma financiare për ata në nevojë (evidenca 37). Institucioni në mbështetje të kriterëve specifike të parashikuara në aktet e tij ofron bursa studimi dhe i bënë ato publike. Administratori krijon komisionin Ad-Hoc për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimi bëhet me vendim të Bordit të Administrimit të UniBa.			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Këto procedura janë lehtësisht të kuptueshme, të aksesueshme në faqen online dhe janë zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UniBa u kushton vëmendje të veçantë marrëdhënive me studentët. Përmes koordinatores së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët informohen në detaje lidhur me vlerësimet për lëndët gjatë gjithë vitit akademik, sikurse dhe frekuentimi me 50% të orëve në leksione dhe 75% të orëve në seminare. Kalimi në vitin pasardhës bëhet nëse studenti ka grumbulluar 50% të krediteve (neni 7 i rregullores së programit të studimit). Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit të studentëve dhe sekretaritë mësimore u bëjnë me dije studentëve të gjitha evidencat mbi rezultatet e tyre akademike sipas krediteve të formalizuara në Ligjin 80/2015 (evidenca 3).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të	Në UniBa studentët informohen në lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. E gjithë kjo procedurë është e

kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	rregulluar me dokumentacion dhe parashikohet në rregulloren e transferimeve, rregulloren e programit të studimeve si dhe në Manualin e Rekrutimeve Aplikim Regjistrim Transferim. (evidenca 18 - 19)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UniBa i informon studentët në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve të parashikuara në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” (evidenca 3). Në kreun III të kësaj Rregulloreje janë përcaktuar mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve, e drejta për të hyrë në provim pasi studenti ka ndjekur mjaftueshem orët e leksioneve dhe seminareve, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimit. Krahas njohjes me Rregulloren, kontakteve me koordinatoren e programit dhe sekretaritë, studentët informohen nga çdo pedagog në orën e parë të lendës, ku prezantohet programi dhe u bëhen të qarta studentëve format e vlerësimit të dijeve, aftësive e kompetencave (verifikimi i syllabuseve ku përcaktohen këto komponentë në mënyrë të unifikuar sipas kuadrit rregullator). Po ashtu, në Rregulloren akademike të UniBa, përcaktohen format e kontrollit dhe të vlerësimit të dijeve (evidenca 2).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimit janë të shprehura qartë në Rregulloren e programit të studimit në kreun IV të saj si dhe në Paketën e provës finale (evidenca 3 & 5). Institucioni UniBa ka hartuar një dhëzues në formën e rregullores “Udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe të mbrojtjes së provës finale për diplomën e studimeve master” (evidenca 5 & 2.2). Studentët njihen me këtë dokument në fillim të semestrit të dytë nga koordinatori i studimeve master të UniBA. Në rubrikën 2.4 të këtij dokumenti “Përgjegjësit e Studentit”, pika a. shprehet “Studenti duhet të jetë i familjarizuar me rregullat e procedurave të provës finale” Gjatë takimit me studentët GVJ konfirmoi se instiucioni nëpërmjet strukturave përkatëse kryente informimin për procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Mbështetur në Strategjinë e Marketingut dhe të Rekrutimit UniBa planifikon dhe zbaton kalendarin vjetor të aktiviteteve të cilat kanë si qëllim rekrutimin e studentëve të rinj në programet e studimit që ofrohen (evidenca 29). Disa prej natyrës së aktiviteteve janë: Konferencë me mësuesit në karrirë të gjimnazeve dhe jo vetëm; Konferencë me maturanët; Vizitat e stafit në institucionet arimore të arsimit parauniversitar; Ekskursion të maturanëve në mjediset e UniBa; Në çdo fillim të vitit akademik UniBa zhvillon “Javën e orientimit” për të interesuarit dhe studentët e ardhshëm. (evidenca 29.1)
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm</i>

	<i>mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	UniBa e ka praktikë pozitive faktin që në fillim të vitit akademik informon studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen dhy vjeçare të programit të studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". Ngritja e strukturës Dekani i Studentit është një qasje mbështetëse dhe pozitive për studentin dhe për ta përfshire jo vetem ne qasjet sociale te institucionit por edhe për informimin e tyre rreth kohëzgjatjes e organizimit të programit të studimit. (evidenca 37) Nga biseda me personelin akademik dhe administrativ, konfirmuar edhe nga studentët, ky informacion jepet që në javën e parë të informimit e në vazhdimësi për çdo nevojë që paraqesin studentët. Po ashtu, me fillimin e programit mësimor, pedagogu Koordinator i Departamentit orienton studentët për të gjithë komponentët që kanë lidhje me organizimin e programit të studimit. Fletëpalosjet në mjediset hyrëse të UniBa dhe të dhënat e detajuara në faqen e internetit të UniBa sigurojnë informimin e plotë për programin e studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik".
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	UniBa dëshmon se vë në dispozicion të studentëve informacionin dhe dokumentacionin për lëndët, modulet dhe veprimtaritë formuese. Në fillim të çdo semestri atyre u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës programi lëndor ku janë specifikuar temat me literaturën e detajuar si dhe format e vlerësimit të dijeve. GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin e zhvilluar me studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". (evidenca 2 & 2.2; vizita në institucion)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UniBa ka krijuar një rrjetë bashkëpunëtorësh dhe partnerësh me të cilët ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale të cilat janë orientuese për tregun e punës (Tregu i punës, çelësi i një karriere të sukseshme: https://www.umb.edu.al/news4856.html). Po

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>ashtu, Bordet e Karrierës të ngritura vitet e fundit punojnë veçanërisht për të përmbushur këtë qëllim (https://www.umb.edu.al/news1140.html).</p> <p>Dokumentacioni shoqërues dëshmon se nga marrveshjet e bashkëpunimit që UniBa ka me institucione publike dhe sipërmarrje private studentët mund të përfitojnë mëbështetje për punësim dhe zhvillim karriere. (evidenca 10.2)</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen mbi gjithë komponentët e zhvillimit dhe organizimit të procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, si nëpërmjet komunikimeve elektronike, nëpërmjet e-mailit zyrtar, ashtu dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me ta. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët dhe përfaqësuesit e Qendrës së Karrierës dhe Alumni, GVJ u njoh me format e informimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sistemi i menaxhimit të brendshëm ➤ Veprimtari informuese që organizon vetë departamenti; ➤ Informim nga personeli akademik; ➤ Informim nga strukturat administrative; ➤ Informacioni i marrë në faqen zyrtare të internetit; <p>Informacioni vihet në dispozicion të një publiku më të gjerë me anë të njoftimeve të zyrave të informimit apo Karrierës dhe Alumni në website-in zyrtar të UniBa. (evidenca 11.2 & 11.3)</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Të gjitha format e renditura në kriterin 4 të këtij standarti u japin mundësi të barabartë të gjithë studentëve për të qenë të informuar. GVJ pas vizitës në institucion konfirmon se sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit është funksional dhe realizon në kohë reale informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët sipas viteve dhe semestrave, krediteve, etj. i cili publikohet në faqen online të UniBa dhe u nisat me e-mailin personal studentëve. Gjithashtu vlerësimet e testeve, provimeve dhe detyrave studentët mund t'i gjejnë në portalin studentor: http://studentportal.umb.edu.al</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UniBa vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit përmes një serë instrumentesh të verifikuara gjatë vizitës në institucion si: faqes së internetit i aksesueshëm nga të gjithë, fletëpalosjeve, kontakteve të drejtpërdrejta në auditor etj. GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Mbështetur në dokumentacionin shoqërues, UniBa dëshmon se mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarëve, në programin e studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik”. GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin me sekretarinë mësimore dhe përfaqësues të zyrës së Alumnit dhe karrierës. (evidenca 30)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ konfirmon se Sekretaria Mësimore e UniBa mban në mënyrë të rregullt regjistrat dhe një bazë të dhënash të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik”, studentët e transferuar apo ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër si edhe ata që janë ç’regjistruar. (evidenca 30)
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni ka një sistem të brendshëm elektronik të menaxhimit të të dhënave. Depozitimi i të dhënave për secilin student realizohet nga Sekretaria e Studimeve Master. Të dhënat për ecurinë e studentëve që nga pranimi deri në diplomim, janë të regjistruara si në regjistrin e të dhënave në letër, sipas formateve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ashtu edhe në formë elektronike, të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Portali studentor përdoret jo vetëm nga studentët por edhe nga sekretaria mësimore që në çdo kohë ka akses për të hedhur notat dhe rezultatet e provimeve, datat përkatëse të zvillimit të provimeve dhe kalendarin e provimeve, etj. (evidenca 23)
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Në dokumentet e shqyrtuara dhe takimi me drejtuesit e institucionit, dëshmohet se UniBa ka raporte periodike me analiza vjetore të rezultateve të arritura prej studentëve, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi (evidenca 22.1). Përdorimi i sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe portalit studentor, ku gjenden të dhënat mbi rezultatet akademike të studentëve, si dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta, pasi përpunohen nga sekretaria mësimore, kalojnë për shqyrtim tek drejtuesit e institucionit.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	Departamenti realizon analizën vjetore mbi organizimin e programeve të studimit që janë pjesë e tij. Analiza vjetor reflekton një rreth shtjellimit të objektivave të realizuara nga departamenti. Raporti jep informacion dhe për profilit dhe cilësinë e studentëve, dhe rezultatet e arritura prej tyre deri në diplomim. Zyra e Alumnit ndjek karrierën e tyre pas

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	diplomimit dhe mban kontakte për realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me punësimin. Pjesë e analizës vjetore janë edhe sugjerimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve. (evidenca 22.1)			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre në programin e studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". Përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni ka siguruar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore të tij. Më konkretisht, në Statutin dhe Rregulloren e tij përcaktohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse si në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë (evidenca 1 & 2). Institucioni ka një rregullore dedikuar Qeverisë Studentore ku vendosen parimet e politikës të Mbështetjes, Përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative të tyre. Gjithashtu mbledhjet e Departamentit organizohen një herë në muaj dhe janë të hapura edhe për studentët (evidenca 20 & 20.2)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve në vendimmarrje garantohet, si përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse, po ashtu edhe nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve në mënyrë periodike për mësimdhënie, që realizohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë çdo semestër, dy javë përpara mbarimit të tij, me secilin grup, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Rezultatet përcillen në Departament dhe Dekanat si dhe pedagogëve për të reflektuar në mësimdhënie (evidenca 10). Formulari i vlerësimit të studentëve që GVJ iu vu në dispozicion gjatë takimit në institucion përmban 5 komponentë: 1. Organizimi i lëndës; 2. Përmbajtja e Lëndës;

	<p>3. Materialet e lëndës;</p> <p>4. Komponentët e vlerësimit;</p> <p>5. Pedagogu, për të cilat studentët japin gjykimet e tyre anonime dhe shqyrtoi raportet e vlerësimit të studentëve (evidenca 11.1 & 23.1 & 33).</p>								
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me përfaqësuesit e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe shqyrtimit të dokumentacionit, vlerëson përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit (evidenca 10 & 23.1). Rezultatet e pyetësorëve u komunikohen me e-mail pedagogëve individualisht dhe përdoren si nga pedagoget, Departamenti dhe strukturat e tjera për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien.</p> <p>Studentët njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies. Në këtë mënyre, UniBa garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve</p>								
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve është pjesë përbërëse e syllabusit në çdo lëndë dhe ofron shpërndarjen e pikëve dhe të përqindjeve të vlerësimit sipas rubrikave përkatëse. Që në fillim studenti e di se testimi final është 50% e vlerësimit, frekuentimi është 10%, detyra e kursit 20% dhe testet gjatë vitit janë 20%. Nga verifikimi i syllabuseve rezulton që formatet e tyre janë të unifikuara dhe format e kontrollit të dijeve të diversifikuara. Studenëve ju lihet kohë për argumentimin nga pedagogu i lëndës i vlerësimit, nëse kanë pakënaqësi për vlerësimin. Zhvillimi i seancave sqaruese dhe rishikimi i vlerësimit janë tregues i vëmendjes së institucionit ndaj transparencës me studentët gjatë procesit të vlerësimit (evidenca 2).</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre në Masterin e Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i></p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrjnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UniBa ka krijuar të gjitha strukturat dhe procedurat e posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve si Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Koordinatorit i Departamentit. Institucioni organizon në fillim të vitit akademik “Javën e orientimit” gjatë të cilës personeli akademik i departamentit i njih studentët me programin. Strukturat e sipërpërmendura kryejnë funksione në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UniBa, për shërbimet e kërkuara nga studentët që nga regjistrimi, deri në diplomimin (evidenca 20.1 & 19.1).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Njesia bazë ka në stukurë një koordinator për çështjet e mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe programin e studimit i cili ka për funksion informimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve. Gjithashtu ai i asiston studentët për çështje që lidhen me procesin mësimor. Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua nga studentët se ata marrin gjithë shërbimet e kërkuara që nga informimi, këshillimi dhe asistimi për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për aktivitete e shërbime brenda e jashtë UniBa-s, për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore. Madje një ndër arsyt pse studentët parapëlqyen të studionin në UniBa ishte edhe gatishmëria e stafit mbështetës për të plotësuar nevojat e tyre studentore.(vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UniBa ofron shërbimin e këshillimit për karrierën për studentët dhe në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Klubi i Karrierës (http://umb.edu.al/news1283.html). Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale apo informime në lidhje me mundësitë e punësimit të tyre. Ndërkohë që po brenda UniBa është ngritur edhe Klubi i Karrierës i cili përbën ndër klubet studentore që organizon studentët dhe zhvillon me to aktivitete lidhur me zhvillimin e tyre të karrierës. Synimi i këtij klubi është zhvillimi dhe përmirësimi i aftësive individuale dhe profesionale të tyre, për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregun e punës. (evidenca 00 & 20.1)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Alumni dhe Karrierës në UniBa ndjek studentët e diplomuar, komunikon me ta dhe ka siguruar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Studentët e diplomuar ruajnë e-mailin e UniBa edhe një vit pas diplomimit. Kjo i cili shërben institucionit për të vazhduar komunikimet me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit kur kanë qënë student. Zyra e Alumni dhe Karrierës zhvillon edhe sondazhe me studentët e diplomuar konform rregullave të UniBa dhe i pasqyron rezultatet në raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve të diplomuar (evidenca 39). Zyra e Alumni dhe Karrierës i mbledh studentët e diplomuar në aktivitete ku ata ndajnë përvojat e tyre dhe</p>

	informacione për tregun e punës (Barleti Alumni Reunion: https://www.umb.edu.al/news4899.html).			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët e Masterit të Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies institucioni ka hartuar udhëzues për mësimdhënien dhe të nxënërit në shkollat e larta. Në këtë dokument trajtohen çështje si: <ol style="list-style-type: none"> 1. Veçoritë të mësimdhënies dhe të nxënërit në arsimin e lartë; 2. Metoda të mësimdhënies; 3. Formate programesh, instrumente vlerësimi dhe vetëvlerësimi; Stafi akademik mbështetet në Udhëzuesin për metodat e mësimdhënies (evidenca 11), për të cilat organizohen edhe trajnime në institucion.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	UniBa nëpërmjet NJZHKC dhe Zv. Rektori për çështjet mësimore të cilët janë edhe strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor vlerësojnë në mënyrë periodike mësimdhënien, aplikimin e të rejave në metodat e mësimdhënies si nga ana e personelit akademik ashtu edhe për personelin ndihmësakademik. Mekanizmat e monitorit janë nëpërmjet: <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi që studentët bëjnë në përfundim të çdo semestri lidhur me performancën e personelit akademik në mësimdhënies; 2. Vlerësimi peer to peer midis kolegëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies; 3. Nëpërmjet analizave dhe rrahjes së mendimeve në njësinë bazë;




	(evidenca 11.1)			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Të dhënat e paraqitura nga UniBa tregojnë që përfshirja e studentëve në vlerësimin e formave të mësimdhënies kryhet në mënyrë periodike e në mënyrë të vazhdueshme. Nga takimi që GVJ pati me studentët u konfirmua që ky proces kryhej në vazhdimësi dhe me seriozitet. Ata dëshmuuan se nuk kanë patur raste ankimesh dhe se disponibiliteti i strukturave përgjegjëse nuk i'u mungonte.			
	(evidenca 12.2.2)			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë si struktura përgjegjëse për monitorim dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie i bënë publike gjetjet në disa forma si; përcjelljen e gjetjeve në njësinë kryesore e më pas në njësinë bazë dhe në fund personelit akademik, publikon gjetjet në faqen zyrtare të UniBa http://umb.edu.al/dossier-uniba.html . GVJ përdori linkun e vënë në dispozicion në RVB dhe konfirmoi hedhjen e tyre në faqen e institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimi i vazhdueshëm në disa nivele i personelit akademik përsa i takon metodave të mësimdhënies dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, punës kërkimore etj nxisin stafin për përmirësim të vazhdueshëm të punës së tyre dhe promovojne shembuj të praktikave të mira. (evidenca 00)			
Konkluzione	<i>UniBa ka politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit për programin e studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UniBa janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. UniBa harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi (https://www.umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html). Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

 53

<p>nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>është Njësia e Zhvillimit të Kurikulës dhe Cilësisë (NJZHKC), Komisioni i Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë. Standardet për sigurimin e cilësisë në UniBa janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Në strategjinë e zhvillimit të UniBa 2020-2030 janë përcaktuar objektiva të qartë dhe të matëshëm lidhur me cilësinë e procese akademike. (evidenca 1.3 & 17 & 17.1 & 12)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UniBa ka njësinë e zhvillimit të Kurikulës dhe cilësisë (NJZHKC) i cila ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. NJZHKC ka akses në të gjitha të dhënat e UniBa, dhe realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në UniBa. Gjithashtu komisioni i sigurimit të cilësisë jep sygjërimi dhe rekomandone në funksion të përmirësimit të cilësisë në institucion. Në Statutin e UniBa, neni 10, 28, në Rregulloren e UniBa, neni 14, 15, në aktet e tyre rregullatore, dhe në Rregulloren e Njësive të Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë përcaktohen dhe zbatohen proceset themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të cilësisë së mësimdhënies dhe në zhvillimin e kurrikulave, mbështetur në kuadrin ligjor të arsimit të lartë dhe në vendimet e udhëzimet e strukturave drejtuese të institucionit. (evidenca 1.3)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UniBa përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Instrumenti që përdor UniBa për sigurimin e cilësisë është “Manuali i Cilësisë” i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit nga autoritetet kombëtare në fund të vitit 2021. NJZHKC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm duke ftuar ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies mblidhen të dhëna nga stafi akademik nga njësitë bazë e kryesore, nga studentët nga të diplomuarit nga stafi administrativ dhe mbi bazën e analizave krahasuese të tyre gjykohet për përmirësim të proceseve që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit. (Takimet në institucion me të gjithë përfaqësuesit e stafit akademik, administrativ dhe studentëve).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni dëshmon se si tregues të matshëm për mësimdhënie dhe kërkim-shkencor përdor vetëdeklarimin që personeli akademik bënë në përfundim të çdo semestri dhe nëpërmjet vlerësimit që drejtuesi i njësive bazë i bënë punës së çdo personeli akademik, anëtar i njësive e cila është një procedurë e standartizuar në institucionet e arsimit të lartë në vend. <i>Duke mbajtur në konsiderat që kjo formë është vetëdeklaruese dhe nuk përmban tregues të detajuar për vlerësimin e procesit mësimor GVJ sygjëron hartimin e një kuadri vlerësues me tregues konkret të pikëzuar sipas rëndësisë dhe peshës që ato duhet të kenë për këtë</i></p>

	<i>vlerësim.</i> Kjo mënyrë do të mundësojë evidentimin e praktikave më të mira në mësimdhënie nga personeli akademik dhe promovimin e personelit akademik me arritje në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka politika dhe procedura transparente në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në programin e studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil "Politika Europiane dhe Administrim Publik". GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit është sektori i kurrikulës, vlerësimi institucional dhe alumni që janë ngritur brenda NJZHKC-së dhe Zv. Rektori për çështjet akademike. Në nivel njësie bazë, është Departamenti që ka programin e studimit, i cili së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve dhe përgjegjësit e grup-lëndëve është përgjegjës për sigurimin e cilësisë. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dhe Departamenti janë strukturat kryesore që bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën e tyre për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen e rishikimin e këtij programi. UniBa përmes NJZHKC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Universiteti. Përmbajtja e këtyre raporte trajtohet në disa nivele brenda institucionit. NJZHKC nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, zbulon problematika të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës dhe i referon ato departamentit për rishqyrtim. Në kuadër të objektivave të saj, NJZHKC siguron bazën e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. Në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë, NJZHKC mbikëqyr efikasitetin e kurrikulave, pasqyrimin e tyre me korrektësi në programet lëndore, në formatin e vlerësimit të miratuar, dhe në literaturën e vënë në dispozicion të studentëve.</p> <p>Raportet e realizuara nga NJZHKC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në nivel Rektorati ku Zv. Rektori për çështjet akademike organizon dhe mbikëqyr punën e fakulteteve dhe programeve me qëllim rritjen e</p>

	standarteve të cilësisë, në programet e studimit të ofruara nga UniBa dhe mësimdhënies nga ana e personelit akademik. (evidenca 17 & 17.1 & 22.1)
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	<p>Monitorimi i procesit të përbushjes së masave në kuadër të gjetjeve të konstatuara realizohet nga NJZHKC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorëve.</p> <p>Në raportet e hartuara evidentohen dhe raportohen çështje si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Cilësia e materialeve mësimore (literaturës); ✓ Cilësia e performancës së personelit akademik; ✓ Komunikimi pedagog-student; ✓ Konceptimi i transparencës në vlerësim; ✓ Përputhja e materialit lëndor me format dhe mënyrat e vlerësimit; ✓ Raporti teori/ praktikë në kurrikula, etj; <p>Gjetjet ju bëhen me dije personelit akademik të departamentit dhe në mbledhjet e organizuara në këtë njësi ato bëhen objekt i analizës vjetore. Një tjetër formë është edhe sistemi i raportimit të personelit akademik në fund të çdo jave për ecurinë e procesit mësimor dhe lënë të dokumentuar komentet përkatëse lidhur me mangësitë e konstatuara.</p>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>UniBa për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” përdor metoda të drejtpërdrejta sikurse janë raportimet në nivel departamenti, vlerësimet periodike të procesit mësimor të kryera nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë si dhe monitorime në nivel institucional nga Zv. Rektori për Çështjet Akademike. Departamenti organizon takime mujore periodike për ecurinë e procesit mësimor, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore të punës së Departamentit, ku krahas mendimeve të pedagogëve, përfshihen edhe vlerësimet e studentëve për lëndët dhe pedagoget (evidenca 38). Institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejt për didaktikën, kurrikulën, të mësuarit dhe provimeve. Disa prej tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vet-raportim i personelit akademik për punën simestrale; ➤ Mbledhje periodike e njësisë bazë që ka përgjegjësinë për programin dhe ka për objekt ecurinë e procesit mësimor; ➤ Vlerëim paraprak i tezës së provimit nga drejtuesi i njësisë bazë; ➤ Raporti vjetor i njësisë bazë ku analizohen arritjet dhe mangësitë e procesit mësimor; <p>(evidenca 11.1)</p>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar	<p>Institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejt për didaktikën, kurrikulën, të mësuarit dhe provimeve. Disa prej tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Formular vlerësimi i studentëve për lëndën; ➤ Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë; <p>Informacioni i synuar lidhet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimin e lëndës;

(alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<ul style="list-style-type: none"> - Programin e lëndës; - Materialet e lëndës; - Komponentët e vlerësimit; - Pedagogu; - Materialet e mësimdhënies; - Performanca e klasës; - Vëzhgime; <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi realizimin e tyre si nga studentët ashtu edhe nga takimi me personelin akademik që shërben në programin e studimit. (evidenca 11 & 11.1 & 11.2)</p>						
Konkluzione	<i>UniBa monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet përmes metodave të drejtpërdrejta, dhe jo të drejtpërdrejta. Departamenti organizon takime mujore periodike për ecurinë e procesit mësimor, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore të punës së Departamentit, ku krahas mendimeve të pedagogëve, përfshihen edhe vlerësimet e studentëve për lëndët. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Bazuar në Rregulloren e UniBa, standardet dhe cilësia, përfshijnë disa struktura si:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë b. Komisioni Për Vlerësimin e Standarteve dhe Cilësisë c. Zv. Rektor për veprimtarinë akademike; d. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master e. Grupet ad hoc të vlerësimit të brendshëm; f. Zyra e Burimeve Njerëzore; <p>UniBa realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si Erasmus + (evidenca 00 & 2). Nga shqyrtimi i Rregullores së Standarteve dhe Cilësisë përcaktohet se 4 prej anëtarëve të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë janë përfaqësues të personelit akademik, përfshirë edhe përfaqësues të personelit akademik me kohë të pjesshme, të cilët janë ekspertë të fushës në institucione të ndryshme</p>

	publike dhe OSHC, si Bashkinë e Tiranës, etj. (evidenca 8.1). Nga takimi në institucion, GVJ konfirmon se UniBa garanton përfshirje të aktorëve të brendshëm dhe jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	UniBa ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për anëtarët përbërës të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në Rregulloren e UniBa, Rregulloren e Komisionit dhe Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Planet e punës të këtyre njësive tregojnë se këto detyra zbatohen në praktikë dhe GVJ e konfirmoi këtë edhe nga takimet në institucion. (evidenca 66)
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në Studime Europiane me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” garantohet përfshirja e personelit akademik nga Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, stafit ndihmës administrativ dhe studentët – 1 përfaqësues i të cilëve ishte në GVB. Metodologjia dhe procesi i hartimit të RVB e përshkruar në hyrje të raportit dhe e konfirmuar nga biseda me grupin e vlerësimit të brendshëm tregon përfshirjen e përfaqësuesve nga Departamenti, anëtarë të personelit akademik, nga personeli administrativ dhe një student i këtij programi studimi.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	UniBa ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit të njësive respektive si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni ...etj. Institucioni ka përcaktuar standarde në Kodin e Etikës që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset ciklike të vlerësimit (evidenca 59). GVJ nga biseda me stafin akademik dhe zyrat respektive që merren me vlerësimet konfirmon se komunikimi i rezultateve të vlerësimit të stafit akademik bëhet në mënyre individuale për çdo personel akademik dhe problematikat në përgjithësi diskutoheshin në mbledhjet e Departamentit për të marrë vendime unanime.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Proceset e vlerësimit të programit të studimit përfshijnë në diskutime edhe bashkëpunëtorët e Departamentit, të angazhuar si staf akademik i jashtëm, apo ata që monitorojnë praktikën e studentëve, që janë përfaqësues të institucioneve partnere, apo ish student alumni. Mendimet dhe ekspertiza e tyre vjen nëpërmjet diskutimeve në mbledhjet e departamentit, aktiviteteve të përbashkëta, si projekte, konferenca, etj. GVJ e konfirmon këtë pas bisedave me stafin akademik efektiv dhe me kontratë të UniBa, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyrojnë aktivitetet e përbashkëta të Departamentit me partnerët. (vizita në institucion)
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe</i>

	<p><i>informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra. UniBa ka përcaktuar standarde në Kodin e Etikës që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset e vlerësimit. GVJ konfirmon se komunikimi i rezultateve të vlerësimit të stafit akademik bëhet si në mënyre individuale për çdo personel akademik. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyronte aktivitetet e përbashkëta të Departamentit me partnerët, vlerëson se partnerët janë pjesëmarrës në procesin e vlerësimit. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Rektori i Institucionit UniBA. Rregullorja e NJZHKC-së është dokumenti në të cilin përcaktohen rregullat e organizimit të veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë (evidenca 17.1). UniBa ka në faqen zyrtare informacionin e kërkuar, si kusht kryesor i transparencës për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë publikohen në kohë reale në faqen online: https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html dhe të zyrës së performancës: https://www.umb.edu.al/mps.html</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rregullorja e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë në nenin 2 të saj përmban parimet mbi të cilën bazohet sigurimi i brendshëm i cilësisë (evidenca 10). Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato elementë që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me personelin akademik ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJZHKC-së janë transparente dhe publikohen në seksionin e Sigurimit të Cilësisë në faqen e web site-it të UniBADhe në seksionin e Vlerësimit të Performancës. GVJ hyri në këto site dhe konfirmoi publikimin e tyre. (evidenca 00)</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni realizon në vijueshmëri procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Struktura të universitetit me Urdhër të Rektorit vihen në lëvizje për adresimin hapave që lidhen me përmirësimin e mangësive. Nga shqyrtimi i evidencave disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me</p>

	natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor. (evidenca 11.5.1 & 11.7)			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UniBa reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJZHKC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesi në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. (evidenca 00)			
Konkluzione	GVJ vlerëson se Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive referuar faqes online të UniBa me info për aktivitetet në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë. <i>GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Studime Europiane”, me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti “Marin Barleti””

Pikat e forta dhe afirmime


1. UniBa ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe kushte infrastrukturore sipërore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit.
2. Personeli akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në “Studime Europiane” me profil “Politika Europiane dhe Administrim Publik” përfshin pedagogë të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë, me përvojë në punë, qëndrueshmëri në këtë departament, dhe me profil në përputhje me fushën e programit.
3. UniBa disponon një sistem efikas të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Si për stafin, ashtu edhe për studentët, janë mundësuar forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit, duke siguruar informacionin në kohë reale.
4. Faqja online e UniBa është edhe në gjuhën angleze, e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët, personeli akademik dhe publikun e interesuar.

Pika të dobta

1. Programi i studimit ka numër të ulët të studentëve.(Standarti I—3)
2. Mungesa e një fondi të dedikuar për mbështetjen e kërkimit shkencor të personelit akademik dhe angazhimit aktiv të studentëve. .(Standarti II—3)
3. Programi i studimit ka nivele të ulëta të mobilitetit dhe shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve. .(Standarti I—3)
4. Mungesa e përdorimit të platformave plotësuese të kontrollit të plagjiaturës si “Turnitin, Grammarly, etc.” për grupe ushtrimesh praktike, projekte individuale dhe në grupe. .(Standarti III—1)
5. Një pjese të syllabuseve të lëndëve i mungon përditësimi me literaturë të 5 viteve të fundit. .(Standarti II—4)

Rekomandime

1. Institucioni të ndërmarrë politika proaktive për të rritur numrin e studentëve në këtë program studimin në vitet në vazhdim.



61

2. Të krijohet një fond i dedikuar për departamentin përgjegjës për këtë program studimi në mënyrë që të rritet kërkimi shkencor dhe të arrihen objektivat e vendosura në strategjinë e zhvillimit. Të lidhen më shumë marrëveshje bashkëpunimi si me institucione shqiptare edhe me ato të huaja, siç mund të jenë organizata apo qendra kërkimore.
3. Rritja e përpjekjeve për përthithja e fondeve nga vendi por edhe të huaja në formën e projekteve kërkimore shkencore dhe të shkëmbimeve.
4. Të shtohen lëndët me zgjedhje si ofertë akademike për studentët.
5. Angazhimi i universitetit në një sistem që mat plagjiaturën e punimeve të studentëve.
6. Biblioteka të pasurohet me botime të viteve të fundit si nga studiuesit shqiptarë dhe të huaj në fushën e studimeve Europiane, të cilat duhet të reflektohen edhe në syllabuset e lëndëve për të mundësuar plotësimin e lëndëve me literaturë të 5 viteve të fundit.


Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "European Studies", with profile "European Politics and Public Administration" provided by the Higher Education Institution "University "Marin Barleti"

Strengths and affirmations

1. UniBa has made available learning environments and modern infrastructural conditions, in technical and didactic aspects, in accordance with the specific nature of the study program.
2. The academic staff covering the Master of Science study program in "European Studies" with the profile "European Politics and Public Administration" includes qualified lecturers with scientific degrees and titles, with work experience, long-term presence in this department, and with a profile in accordance with the program field.
3. UniBa has an efficient internal institutional management system and makes it available for administration, information and monitoring of academic, financial and administrative activities for the study program. For both staff and students, forms of interactive communication and information exchange are enabled, providing information in real time.
4. UniBa's website is also in English with rich in information in accordance with students' needs, academic staff and the interested public.

Weaknesses

1. The study program has a low number of students.




62

2. There is a lack of a dedicated fund for supporting scientific research of academic staff and active engagement of students.
3. The study program has low rates of staff and student mobility and exchange.
4. There is a lack of use of plagiarism control platforms such as "Turnitin, Grammarly, etc." for groups of practical exercises, individual and group projects.
5. Some of the course syllabuses are not updated with literature of the last 5 years.

Recommendation

1. The institution should undertake proactive policies to increase the number of students in the coming years.
2. To create a dedicated fund for the department responsible for this study program in order to increase scientific research and achieve the objectives set in the development strategy. In addition, there is a need to sign more cooperation agreements both with Albanian and foreign institutions, such as organizations or research centers.
3. To increase efforts to absorb funds from national sources but also from abroad in the form of scientific research projects and exchanges.
4. To add elective courses as an academic offer for students.
5. The university's commitment to a system that measures plagiarism of student work.
6. The Library should be enriched with publications from recent years, both from Albanian and foreign authors in the field of European studies, which should also be reflected in the course syllabuses to enable the completion of courses with literature from the last 5 years.



63

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen plotësisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X